



## Forca Detare, 97 vjet lundrim nëpër histori sukse

E rëndësishme dhe historike fuqia e këtij asemi të Ushtrisë Shqiptare, rrugëtimi i së cilës na bën krenar.

Në prag të shekullimit të tij vjen e transformuar dhe me sfida të reja drejt së ardhmes. Komandant i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, me një eksperiencë të gjatë në fushën e mbrojtjes dhe me një formim të gjerë akademik, në një intervistë për shtypin ushtarak sjell zhvillimet dhe risitë e një prej

forcave elitare të Forcave të Armatosura. Kur është krijuar Forca Detare?

Forca Detare është krijuar, më 25 dhjetor 1925, por traditat detare të popullit tonë janë po aq të lashta sa vetë historia e tij. Këtë traditë e trashëgojmë që nga flota e famshme e mbretit Bardhyl dhe mbretëreshës Teuta, që përballuan tre luftëra me flotën romake, tek kapedanët e famshëm ulqinakas e arvanitas, tek krijesit e flotës detare të shtetit të parë

shqiptar, deri te arkitekti dhe ndërtuesi i Flotës Luftarake Detare, kundëradmiral Abdi Mati. Historia moderne e Forcës Detare daton më 25 dhjetor 1925, kur një grup marinarësh nën drejtimin e Ahmet Kapedanit valëviten flamurin shqiptar në ujërat tona territoriale. Anijet "Shqiponja" dhe "Skënderbeg" dhanë sinjalin e parë të patrullimit të Forcës Detare, në emër të ruajtjes së kufirit detar të shtetit shqiptar. Lufta e dytë botërore... >> faqe 6-7



## Ministri Peleshi: Avionët luftarakë "Bayraktar", me rëndësi për sigurinë tonë kombëtare dhe të Aleancës



>> faqe 3

Komandanti i Komandës Supreme Aleate të Transformimit të NATO-s, gjeneral Philippe Lavigne, pritët nga gjeneral brigade Arben Kingji

Komandanti i Komandës Supreme Aleate të Transformimit të NATO-s (ACT), gjeneral Philippe Lavigne zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë, ku u prit me truproje nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji. Gjatë takimit në Shtabin e Përgjithshëm, gjeneral brigade Kingji e njohu gjeneral Lavigne me zhvillimet më të reja të FARSH, si dhe rolin që ka Shqipëria në kontekstin e bashkëpunimit dhe sigurisë rajonale e më gjerë. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit kanë ndarë pikëpamjet në tematika...



>> Faqe 2

Peleshi: Financim 30 milionë euro për logjistikën në emergjencë

Qeveria miratoi, marrëveshjen ndërqeveritare me Republikën e Italisë për ngritjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi në përfundim të mbledhjes se ky është një angazhim i Italisë që në Konferencën e Donatorëve pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, që premtoi të mbështesë sistemin e Mbrojtjes Civile të Shqipërisë me një financim në formë huaje prej 30 milion eurosh. "Kredia parashikon mbështetjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile, që nuk i përket një institucioni..."



>> Faqe 2

"Nëse Shekspiri do të ishte grua, nuk do të kish patur kurrë kohë për t'u bërë një gjeni"

Gratë nuk e kanë pasur kurrë luksin e të pasurit mjaftueshëm kohë për veten. Nëse i hedh një sy rutinës ditore të disa prej artistëve më të mëdhenj të kohërave (shumica meshkuj) do të vëresh shumë aspekte interesante. Gratë u jepnin kohën e nevojshme për të krijuar, shërbëtorët u sillnin rregullisht për të ngrënë e për të pirë ndërsa edukatorët i mbanin fëmijët sa më larg. Le të marrim rastin e Zigmund Frojdit. Gruaja e tij Marta, jo vetëm që i bënte gati ndërresat çdo mëngjes por edhe hidhte pastën në furçën e dhëmbëve...



>> Faqe 10

# Komandanti i Komandës Supreme Aleate të Transformimit të NATO-s, gjeneral Philippe Lavigne, pritët nga gjeneral brigade Arben Kingji

**K**omandanti i Komandës Supreme Aleate të Transformimit të NATO-s (ACT), gjeneral Philippe Lavigne zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë, ku u prit me truproje nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji.

Gjatë takimit në Shtabin e Përgjithshëm, gjeneral brigade Kingji e njohu gjeneral Lavigne me zhvillimet më të reja të FARSH, si dhe rolin që ka Shqipëria në kontekstin e bashkëpunimit dhe sigurisë rajonale e më gjerë. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit kanë ndarë pikë-

pamjet në tematika të ndryshme, duke u ndalur në rëndësinë e rritjes së kapaciteteve të mbrojtjes nga vendet anëtare, si dhe implementimit të vendimeve të Samitit të NATO-s në Madrid.

Një tjetër temë e rëndësishme gjatë takimit të dy drejtuesve të lartë ushtarakë ishte rreth koncepteve që Komanda e Transformimit po zhvillon për formësimin e instrumentit ushtarak të së ardhmes, për të qenë në gjendje për të kuptuar realitetin e ri gjeostrategjik dhe për të ndërvepruar e punuar së bashku në përballimin e sfidave të së ardhmes.



## Peleshi: Financim 30 milionë euro për logjistikën në emergjencë

**Q**everia miratoi marrëveshjen ndërqeveritare me Republikën e Italisë për ngritjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi deklaroi në përfundim të mbledhjes se ky është një angazhim i Italisë që në Konferencën e Donatorëve pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, që premtoi të mbështesë sistemin e Mbrojtjes Civile të Shqipërisë me një financim në formë huaje prej 30 milion eurosh. “Kredia parashikon mbështetjen e Sistemit të Mbrojtjes Civile, që nuk i përket një institucioni. Drejtohet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nën Ministrinë e Mbrojtjes, por është i shtrirë në të gjithë territorin dhe të gjitha nivelet, duke filluar nga niveli lokal, bashkitë, prefekturat. Pothuajse i gjithë sistemi preket pozitivisht, pra merr financim nga kjo kredi 30 milion euro”, - sqaroi ministri i Mbrojtjes, sipas të cilit marrëveshja do të kalojë në Parlament për ratifikim dhe më pas do të jetë aktive. Sipas ministrit Peleshi plani parashikon ndërtimin e një qendre të mirë pajisur me teknologji të standardeve të B-së në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile: “Paralel me të në të gjitha prefekturat dhe në katër qendrat e Agjencisë së Mbrojtjes Civile në territor do të ndërtohen sallat operacionale të pajisura dhe të lidhura me njëra-tjetrën me rrjet duke qenë ndërvepruese. Pranë qendrave të Mbrojtjes Civile do të ndërtohen edhe struktura operacionale të kërkim-shpëtimit shoqëruar edhe me



pajisje, por dhe trajnim. Pra do ketë edhe shtrirje territoriale në katër qendra nëpër Shqipëri, por dhe të gjitha pajisjet në rastet e fatkeqësive natyrore. Për të gjitha bashkitë, strukturat zjarrfikëse në rang kombëtar parashikohet blerja e automjeteve zjarrfikëse dhe automjeteve të tjera si dhe gjithë logjistika për përmbytjet dhe kërkim-shpëtimin në përgjithësi”, - tha Peleshi. Pjesë

e këtij financimi është edhe blerja e dy mjeteve ajrore specifike për luftën kundër zjarreve. “Gjithashtu do të ngrihet një kamp trajnimit për zjarrfikësit dhe të gjitha strukturat operacionale, që duhet të trajnohen, duke përfshirë dhe vullnetarë, Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura. Kjo qendër trajnimit do jetë e pajisur edhe me laboratorë simulimi, pra le të themi me këtë financim

e ngremë në një nivel të lartë gjithë Sistemin e Mbrojtjes Civile. Shpresoj ta kalojmë sa më shpejt në parlament. Tashmë është bërë traditë që për marrëveshjet ndërkombëtare votohet në unison dhe nuk ka dyshime se së shpejti kjo marrëveshje do miratohet dhe aktivizohet menjëherë”, - tha Peleshi.

I pyetur edhe nga media, pas mbledhjes së qeverisë, ministri i Mbrojtjes

foli edhe për diskutimet me komandantin Suprem të NATO-s në Evropë për ndërtimin e një baze ushtarake në një pjesë të portit të ri tregtar të Porto Romanos. Peleshi tha se kjo mund të ndërtohet sipas modelit të Bazës Ajrore të NATO-s në Kuçovë.

“Një nga pikat e diskutimit ka qenë mundësia e mbështetjes nga NATO të portit ushtarak pranë portit të ri të Porto Romanos. Ky është lajm i rëndësishëm për Shqipërinë. Siç e ka thënë komandanti suprem i NATO-s para një viti, kur ishte këtu në Shqipëri, Durrësi si nyje hyrëse për në Ballkanin Perëndimor dhe në krahun lindor të NATO-s është i rëndësishëm për NATO-n. Ajo që po i ofrojmë ne NATO-s është që kjo hyrje të jetë sipas standardeve të NATO-s. Ne jemi duke u konsultuar me NATO-n sipas dizajnit të NATO-s. Krahas konsultimeve ne po punojmë edhe për financimin.

Ka disa opsione për financimin, ka një burokraci që nuk shmanget dot, por ka hyrë në diskutim nga strukturat e NATO-s edhe kjo mënyrë financimi. Kemi një model të ngjashëm që është Baza e Kuçovës. Po ecën me ritme të shpejta. Ka qenë një pikë diskutimi, një investim shtesë për të ndërtuar qendrën e kontrollit të trafikut ajror aty, në Kuçovë, që mund të kushtojë rreth 20 mijë euro të tjera. Shpresoj që të miratohet. Por mbi atë model mund të ecim me Porto Romanon”, - sqaroi ministri Peleshi.

**N**ë prani të kryeministrit Edi Rama, ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, përfaqësuesve të firmës turke "Baykar Technologies", ambasadorit të Republikës së Turqisë në vendin tonë Tayyar Kağan Atay, u nënshkrua në Tiranë marrëveshja për sigurimin e avionëve luftarakë pa pilotë "Bayraktar". Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë fjalës së tij shprehu mirënjohje për ndihmën që qeveria turke ka dhënë vitet e fundit në mbështetje të Forcave të Armatosura: "Jam i sigurt se shfrytëzimi i këtyre aseteve në vendin tonë do të rrisë cilësisht kapacitetet e Forcave të Armatosura dhe strukturave të Emergjencave Civile në drejtim të kontrollit të territorit dhe për të parandaluar fenomenet e paligjshme. Kompletimi me këtë sistem ka rëndësi të veçantë për sigurinë tonë kombëtare dhe atë të Aleancës, si dhe për respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe objektivat e Kapaciteteve të NATO-s", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ministri Peleshi shpjegoi edhe objektivat që kërkohen të arrihen përmes shtimit të këtyre kapaciteteve: "Krijimi i kapaciteteve kombëtare shumëpërdorimshme dhe modulare për zbulim, vëzhgim dhe rikonicion më të mirë, në mbështetje ajrore të operacioneve të FARSH dhe gjatë operacioneve të emergjencave civile dhe operacioneve në ndihmë të komunitetit, do të jenë disa prej objektivave që do të arrihen me sigurimin e këtyre aseteve. Modernizimi i Forcave të Armatosura do të jetë në vëmendje të vazhdueshme të qeverisë shqiptare. Gjatë viteve të fundit kemi bërë të mundur investime konkrete për trajtimin dhe trajnimin e personelit ushtarak, si dhe në blerje të pajisjeve, aseteve të rëndësishme në funksion të Forcave të Armatosura.

Kompletimi me këto sisteme ka rëndësi të veçantë për sigurinë tonë kombëtare dhe atë të Aleancës, si dhe vjen në respektim të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Sigurisë



## Ministri Peleshi: Avionët luftarakë "Bayraktar", me rëndësi për sigurinë tonë kombëtare dhe të Aleancës



Kombëtare, Strategjia Ushtarake dhe objektivat e Kapaciteteve të NATO-s", - theksoi z. Peleshi Nga ana e tij, mes të tjerash kryeministri Rama tha: "Me këtë marrëveshje nuk po sjellim këtu në Shqipëri teknologjinë më të mirë të lartë në këtë fushë, por kështu do sjellim në

Shqipëri një fushë të re njohurish dhe është shumë mirë që marrëveshja nuk është vetëm për të blerë dronët por ka të bëjë edhe me ndërtimin e një ure mes FA-ve tona dhe kompanisë Bajraktar që do kujdeset për trajnimin e njerëzve, më shumë se 30 persona që do përzgji-



dhen me shumë kujdes me ndihmën e kompanisë "Bayraktar", që do vihen në një trajnim dhe do përgatiten për të marrë funksionin e qendrës së kontrollit, që do jetë objekt i teknologjisë më të lartë në bazën ajrore të Kuçovës". Firma "Baykar Technologies" është e

specializuar në hartimin e teknologjive transformuese në fushën e Mbrojtjes dhe Aviacionit. Pajisja me këta avionë do t'u ofrojë institucioneve të tjera të qeverisë shqiptare një mbështetje të madhe në nivel operacional, në fusha të ndryshme.

## 55-vjet nga krijimi i ish-Regjimentit të Helikopterëve, Baza Ajrore Farkë

Në mjediset e Bazës Ajrore Farkë është kremtuar 55-vjetori i krijimit të ish-Regjimentit të Helikopterëve, sot Baza Ajrore Farkë. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral-major Manushaqe Shehu, veteranët e aviacionit, të ftuar nga pushteti lokal dhe ushtarakë të Forcës Ajrore.

Komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Pulaj në fjalën e rastit u shpreh: "Që nga krijimi e në vazhdim kjo bazë ka dhënë një kontribut të shquar në realizimin e misioneve të ndryshme ushtarake



dhe civile, ka zhvilluar stërvitje të përbashkëta me ushtritë e ndryshme të rajonit dhe ka ndihmuar komunitetin në zona malore të zëna nga dëbora, në operacionet për tërmetet, si dhe në krizën e kosovarëve në vitin 1999. Reformimi dhe modernizimi i Forcës

Ajrore dhe Bazës Ajrore Farkë, me mjete dhe teknologji perëndimore të gjeneratave të fundit, është një proces i vazhdueshëm dhe i pandërprerë. Së shpejti ne presim kompletimin me helikopterë të tipit "Black Hawk", për të cilët kemi filluar përgatitjen profesio-

nale dhe trajnimin e personelit që do të shërbejë në këto helikopterë."

Në fjalën e saj përshëndetëse me rastin e 55-vjetorit të krijimit të ish-Regjimentit të Helikopterëve, Farkë gjeneralmajor Shehu shprehu se: "Baza Ajrore, ashtu sikurse e gjithë

Forca Ajrore, ka në natyrën e shërbimit të saj nevojën dhe sfidën e vazhdueshme për t'u zhvilluar dhe modernizuar, por edhe për t'u transformuar në përgjigje të kërkesave të reja dhe standardeve bashkëkohore."

Në emër të veteranëve të aviacionit, fjalën përshëndetëse e mbajti, z. Sami Guzina, i cili foli për historikun e kësaj baze dhe vlerësoi punën e palodhur të shumë brezave që kanë punuar në Regjimentin e Helikopterëve. Aktiviteti u mbyll me shpërndarjen e "Certifikatave të Mirënjohjes", për personelin që kanë punuar në këtë bazë dhe sapo kanë dalë në pension, si dhe dhënien e "Medaljes së Pilotit", për disa pilotë të kësaj baze.



# Atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, vizitë në Forcën Detare

**K**omandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një takim në Komandën e Forcës Detare atasheun ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Timothy Wight - Boycott. Qëllimi i takimit ishte njohja me angazhimet dhe planet e modernizimit të Forcës Detare, si dhe mundësitë e bashkëpunimit dypalësh për vitin 2023. Komandanti i Forcës Detare njohu atasheun britanik me angazhimet e Forcës Detare për vitin 2023 në misionet jashtë vendit, si dhe ecurinë e projekteve të modernizimit. Gjithashtu gjatë takimit komandanti i Forcës Detare theksoi rëndësinë e trajnimit dhe

edukimit të oficerëve të Forcës Detare në Britaninë e Madhe dhe se njohuritë e fituara kanë shërbyer në rritjen e profesionalizimit gjatë kryerjes së detyrave në anije. Gjatë takimit, më gjatë u diskutua vijimi më tej i bashkëpunimit me palën angleze në fushën e edukimit dhe trajnimit për personelin e Forcës Detare, në veçanti trajnimi i personelit të Qendrës së Zhytjes, për përdorimin e pajisjeve në operacionet për kërkimin e minave. Në përfundim të takimit atasheu britanik, nënkolonel Timothy Wight - Boycott falënderoi për mikpritjen dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm midis dy forcave detare.

# Në Komandën Mbështetëse u zhvillua ceremonia e daljes në pension e kolonelit Përparim Gega

Në ambientet e Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e daljes në pension e kolonelit Gega, i cili ka shërbyer prej 44 viteve me devotshmëri në Forcat e Armatosura. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandantët e reparteve si dhe Shtabi i KM.

Gjeneral brigade Xhebexhia, në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi punën e devotshme të palodhur dhe profesionalizmin e treguar përgjatë këtyre 44 viteve nën uniformë të kolonelit Gega.

Kolonel Gega është vlerësuar edhe me medalje mirënjohjeje nga shefi Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji. Në përfundim të ceremonisë gjeneral brigade Xhebexhia i dorëzoi certifikatën e mirënjohjes kolonelit Gega, të cilit i uroi sukses të mëtejshme. Kolonel Gega ka lindur në Tropojë, ai ka kryer një sërë detyrash të ndryshme përgjatë këtyre 37 viteve në Forcat e Armatosura, ndër këto 8 vite si zëvendëskomandant i Komandës Mbështetëse.



Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, u hap kursi i 52-të i Avancuar i Nënoficerit, i përbërë nga 55 kursantë, ku 6 prej tyre janë pjesëtarë të FSK-së.

Kursi zgjat gjithsej 8 javë dhe ka si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të rreshterit si drejtues në rol të zëvendëskomandantit të togës dhe detyrave të njësuara me të teknikave të punës dhe ndihmës kryesor për stërvitjen e togës, si dhe në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe drejtuese.



Në batalionin e Tretë të Këmbëorisë vijon përgatitja e kontingjentit për dislokim në kuadër të misionit "KFOR" në Kosovë.



Repartet e Forcës Tokësore zhvillojnë analizën e punës për vitin 2022



Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria kanë një kulturë të fortë bashkëpunimi dhe partneriteti.

Këtë vit, gjatë një periudhe njëmuajore, Regjimenti i Operacioneve Speciale Shqiptare dhe trupat e Brigadës së Operacioneve Speciale të Mbretërisë së Bashkuar u stërvitën së bashku gjatë stërvitjes së pestë "Strong Eagle".

Qëllimi i stërvitjes ishte që pjesëtarët e regjimenteve të mësonin nga njëri-tjetri, të forconin marrëdhëniet ekzistuese profesionale dhe personale dhe të punonin drejt zhvillimit të aftësive të Forcave Speciale Shqiptare.

Kjo marrëdhënie mes dy njësive ka qenë e vazhdueshme për tre vitet e fundit dhe ka shënuar shumë suksese. Së fundmi, falë trajnimit të përbashkët, një ekip nga Regjimenti i Operacioneve Speciale Shqiptare fitoi një medalje argjendi shumë të merituar në konkursin vjetor "Cambrian Patrol" në Uells.



Në mbyllje të vitit stërvitor, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, inspektoi Regjimentin e Operacioneve Speciale nga ku ndoqi nga afër edhe një demonstrim stërvitor, nga efektivët e këtij reparti elitë.



# "Atdheu - Nostalgjia e skënderbegasve"

Në kuadrin e ruajtjes së vlerave dhe traditave të shkëlqyera të ish-shkollës ushtarake "Skënderbej" dhe përfundimit me sukses të karrierës ushtarake në Forcat e Armatosura të skënderbegasve të maturës të vitit 1976, Fondacioni i Lirisë dhe të Drejtave të njeriut "Martin Luther King" në bashkëpunim me klasën 4/2 të maturës së shkollës ushtarake "Skënderbej" të vitit 1976, më datën 17 dhjetor 2022, në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar organizuan aktivitetin "Atdheu - Nostalgjia e skënderbegasve".

Në këtë veprimtari morën pjesë ish-skënderbegas të maturës së vitit 1976, ish-ushtarakë të tjerë ndër vite, mësues dhe komandantë të ish-shkollës të atyre viteve. Në këtë veprimtari mori pjesë edhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu. Takimi u moderua me mjaft kompetencë nga gazetari Dëfrim Methasani.

Veprimtaria nisi me ekzekutimin e himnit kombëtar. Fjalën e mirëseardhjes e mbajti ish-skënderbegasi Adem Ajdini. Më tej aktiviteti vijoi me një dokumentar dhe pastaj me diskutime nga mësues, komandantë e ish-skënderbegas, interpretime e këngë nga vetë skënderbegasit.

Nga mësuesit e ish-shkollës ushtarake "Skënderbej" përshëndeti ish-mësuesja kujdestare Sashenka Deli (Rino), ish-komandantët e kompanisë, Bashkim Bregu dhe Aleks Shajko. Në emër të ish-skënderbegasve përshëndeti zoti Artur Lekbelo "Mjeshtri i Madh" ish-portier i ekipit Partizani, Lokomotiva dhe atij Kombëtar, ndërsa ish-skënderbegasi Jorgo Gjoni interpretoi poezinë "Jemi gjak nga gjaku juaj" të poetit Arben Duka (ndarë nga jeta) ish-skënderbegas i po këtij brezi, ndërsa ish-skënderbegasi Perlat Shehu, ish edhe pjesëtar i Ansambllit të Ushtrisë këndoi këngën "Për ty atdhe". Në emër të ministrit të Mbrojtjes, zotit Niko Peleshi, 33 vetave, ish-skënderbegasve, mësuesve dhe komandantëve të asaj mature, iu dorëzuan "Certifikatë e Mirënjohjes", akorduar nga Ministri i Mbrojtjes, me motivacionin "Për kontributin e dhënë në shërbim të Forcave të Armatosura".

Në fjalën përshëndetëse, që gjeneral Shehu mbajti në emër të Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, shprehur mirënjohjen dhe falënderimet për gjithë drejtuesit dhe mësuesit e ish-Shkollës Ushtarake "Skënderbej", ku ndër të tjera do sillte në vëmendje se: "Shoqëria ushtarake është shoqëria më e sinqertë dhe më e dashur që i bashkon ish-ushtarakët, edhe pas shumë vitesh, aq më tepër ish-skënderbegasit, si jeni edhe ju sot në këtë sallë.

Jam e privilegjuar që jam këtu mes jush në këtë aktivitet mjaft kuptimplotë e domethënëse të titulluar: "Atdheu - nostalgjia e skënderbegasve", të maturës së Shkollës Ushtarake "Skënderbej" të vitit 1976, organizuar nga klasa 4/2 në bashkëpunim me Fondacionin e Lirisë dhe të Drejtave të Njeriut "Martin Luther King" në Shqipëri.

Shkolla Ushtarake "Skënderbej" u krijua menjëherë pas çlirimit të vendit, si domosdoshmëri e përgatitjes së oficerëve të ardhshëm të ushtrisë. Pikërisht më 28 mars 1945, në garnizonin e vjetër ushtarak në Laprakë, u zgjodhën për herë të parë 200 partizanë të vegjël të moshave 14-16 vjeç, midis tyre dhe 7 vajza, duke krijuar shkollën e parë të "Pionierëve të luftës", e cila në vitin 1947 mori emrin e heroit tonë kombëtar, duke u quajtur Shkolla Ushtarake "Skënderbej".



Kjo shkollë e lavdishme e quajtur me të drejtë "Fidanishtja e Ushtrisë" që në fillim dhe deri në mbylljen e saj në vitin 1992, u konceptua dhe u realizua si qendra më e rëndësishme për përgatitjen e kuadrove të ushtrisë, nëpërmjet edukimit patriotik, përvetësimit të programit të arsimit të mesëm, duke hedhur bazat e formimit fillëstar ushtarak dhe për të hapur rrugën drejt shkollave ushtarake për forcat tokësore, ajrore dhe detare.

Për gati gjysmë shekulli nga kjo shkollë e lavdishme dolën mbi 35 mijë nxënës, kontingjente për shkollat e larta ushtarake. Në këtë rrugë të gjatë historike, që nga brezi i parë me pionierët e luftës, deri në vitin 1992, kur shkolla u mbyll, shumë skënderbegas kanë dhënë edhe jetën në krye të detyrës, duke u shpallur dëshmorë të atdheut, të cilët sot janë krenaria e Forcave të Armatosura dhe burim frymëzimi për brezat e rinj të ushtarakëve.

Përveç mësimit, skënderbegasit do t'i gjeje pjesëmarrës në të gjitha aksionet kombëtare të rinisë shqiptare, veçanërisht në ndërtimin e hekurudhave, hidrocentraleve, në aksionet në ndihmë të bujqësisë, në likuidimin e pasojave të tërmetit, në koncerte festive, parada ushtarake, spartakiada, olimpiada të shkollave të mesme, manifestime dhe stërvitje të rëndësishme të ushtrisë, duke u nderuar kudoherë me çmime e vlerësime në rang kombëtar.

Skënderbegasit edhe pse në një moshë të re në edukimin e tyre i udhëhiqte trinomi i kodit moral "Detyra - Nderi - Atdheu".

Me mijëra ish-skënderbegas, pas një shërbimi të gjatë në Forcat e Armatosura,

kanë dalë në pension dhe të tjerë vazhdojnë ende të shërbejnë në radhët e Forcave



të Armatosura si drejtues e komandantë të të gjitha niveleve, deri në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së dhe në strukturat e NATO-s.

Shkolla ushtarake "Skënderbej" krijoi një traditë historike, e cila ka lënë gjurmë në ushtrinë tonë dje, sot dhe për të ardhmen, duke krijuar oficerin e ri shqiptar. Ajo pati meritën e përgatitjes së kontingjenteve për shkollat e tjera ushtarake, për rritjen e standardeve të larta për arsimimin ushtarak, duke u bërë terreni i provës dhe garancisë për suksese arsimore dhe profesionale të kuadrove të ushtrisë. Me dijet e përfituara në të gjithë hierarkinë e shkollave ushtarake, ish-skënderbegasit kanë bërë karrierë të shkëlqyer në radhët e ushtrisë, duke u bërë gjeneralë e ushtarakë madhorë, komandantë, specialistë, pilotë e detarë të shquar, presidentë, ministra, profesorë e

shkencëtarë, deputetë e artistë të mëdhenj, sportistë e mjeshtra sporti, ambasadorë, poetë e shkrimtarë, gazetarë, biznesmenë, politikanë, drejtues të kulteve fetare, etj.

Pjesë e kësaj plejade skënderbegasish, pjesë e kësaj krenaria, padyshim është edhe matura e vitit 1976, që jeni mbledhur sot për t'u takuar e gëzuar me njëri tjetrin. Ju përgëzoj për këtë organizim të shkëlqyer, i cili duhet të shërbejë edhe për brezat e tjerë, jo vetëm të ish skënderbegasve, por në përgjithësi të ushtarakëve.

Për ju kanë kaluar 46 vjet të përfundimit të kësaj shkolle, ku erdhët fëmijë njomzakë 14 vjeçarë, i shërbyet atdheut me përkushtim e devotshmëri anembanë vendit dhe sot, edhe pse të thinjur e të sapo dalë në pension pleqërie, mbi supe mbani me nder krenarinë dhe lavdinë e të qenurit ushtarak i Forcave të Armatosura.

Shkolla Ushtarake "Skënderbej", edhe pse dyert e saj sot janë mbyllur, ajo do të ngelet pjesë e lavdisë së historisë sonë ushtarake. Shkolla "Skënderbej" ishte dhe do të mbetet institucioni arsimor, që kultivoi te Ju dashurinë dhe respektin për njeri-tjetrin,

ishte vatra që kaliti dhe çelikosi solidaritetin midis jush, që do të mbetet një vlerë e patjetërsueshme, një vlerë monumentale.

Sot Akademia e Forcave të Armatosura, trashëgon vlerat më të arrira të kësaj shkolle dhe shkollave të tjera ushtarake, duke i çuar më përpara traditat e përgatitjes së oficerëve të FA-së shqiptare për të qenë të gatshëm për mbrojtjen e vendit, për të vepruar në përbërje të aleancës së NATO-s në dobi të paqes e sigurisë kudo në botë.

Unë sot, si e vetmja femër ushtarake me gradën madhore "gjeneralmajor", edhe pse nuk kam kryer shkollën ushtarake "Skënderbej", kam punuar, shërbyer e drejtuar përkrah oficerëve me prejardhje skënderbegas dhe kam ndier nga afër seriozitetin, ndjenjën e sakrificës, përkushtimin dhe devotshmërinë e tyre në kryerjen e detyrave, të cilët kanë qenë shembull frymëzimi për gjithë ushtarakët e tjerë.

Duke përfituar nga pjesëmarrja në këtë aktivitet shumë të rëndësishëm, më lejoni që t'iu uroj të gjithë skënderbegasve kudo qofshin, të cilët janë skalitur mjaft mirë në katër volumet e librit "Skënderbegasit ndër



vite", shëndet dhe suksese në jetë! Homazh, vlerësim e mirënjohje për ata që janë ndarë nga jeta! Në këtë takim një urim të veçantë dëshiroj të bëj për gjithë mësuesit dhe komandantët e shkollës ushtarake "Skënderbej" ndër vite, një pjesë e të cilëve janë edhe të pranishëm në sallë, vlerësim e mirënjohje pa kufi për kontributin e dhënë në edukimin dhe kujdesin ndaj skënderbegasve të kësaj moshe, të cilët ishin për ta, jo vetëm edukatorë e komandantë, por edhe prindër, vëllezër dhe motra.

Në fund për pjesëmarrësit u shtrua një dreke, e cila kaloi me këngë e humor nga vetë skënderbegasit, në shoqërinë e këngëtarit durrsak Zija Saraçi.

INTERVISTË ME KOMANDANTIN E FORCËS DETARE, KUNDËRADMIRAL ADNAND AGASTRA

# Forca Detare, 97 vjet lundrim nëpër histori sukseesi

INTERVISTOI SHEFE E SEKTORIT  
TË BOTIMEVE,  
ANJEZA MUSOLLARI

*E rëndësishme dhe historike fuqia e këtij aseti të Ushtrisë Shqiptare, rrugëtimi i së cilës na bën krenar.*

*Në prag të shekullimit të tij vjen e transformuar dhe me sfida të reja drejt së ardhmes.*

*Komandant i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, me një eksperiencë të gjatë në fushën e mbrojtjes dhe me një formim të gjerë akademik, në një intervistë për shtypin ushtarak sjell zhvillimet dhe risitë e një prej forcave elitare të Forcave të Armatosura.*

## Kur është krijuar Forca Detare?

Forca Detare është krijuar, më 25 dhjetor 1925, por traditat detare të popullit tonë janë po aq të lashta sa vetë historia e tij. Këtë traditë e trashëgojmë që nga flota e famshme e mbretit Bardhyl dhe mbretëreshës Teuta, që përballuan tre luftëra me flotën romake, tek kapedanët e famshëm ulqinakas e arvanitas, tek krijuesit e flotës detare të shtetit të parë shqiptar, deri te arkitekti dhe ndërtuesi i Flotës Luftarake Detare, kundëradmiral Abdi Mati. Historia moderne e Forcës Detare daton më 25 dhjetor 1925, kur një grup marinarësh nën drejtimin e Ahmet Kapedanit valëviten flamurin shqiptar në ujërat tona territoriale. Anijet “Shqiponja” dhe “Skënderbeg” dhanë sinjalin e parë të patrullimit të Forcës Detare, në emër të ruajtjes së kufirit detar të shtetit shqiptar.

Lufta e dytë botërore shkatërroi plotësisht Flotën Detare. Pas çlirimit të vendit, më 15 gusht 1945, u krijua Flota Luftarake Detare. Vitet 50 zhvilluan një etapë të re për zhvillimin e FD-së, e cila u pajis me katra silurues, dragamina, gjuajtës detar, anije ndihmuese e më pas edhe me 4 nëndetëse, ku u pajis me mjetet më moderne të kohës nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe me vonë me mjete nga Kina.

## Cili ka qenë misioni, detyrat dhe struktura organizative e saj?

Forca Detare në varësi të kohës ka pasur detyra të ndryshme, por ajo që nuk ka ndryshuar asnjëherë, është misioni i cili ka qenë dhe është aktual dhe sot. Përveç misionit tradicional të pandryshuar të Forcës Detare “Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura”, me nevojat që kishte vendi ynë në periudhën pas viteve 90, në vitin 2002 i është shtuar edhe misioni dhe detyrat e Rojës Bregdetare. Misioni aktual është: “Sigurimi dhe ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, në bashkë-



punim me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, zbatimi i ushtrimit të ligjshmërisë në det në bashkëpunim me institucionet shtetërore me interesa në hapësirën detare”.

*Detyrat Kryesore të Forcës Detare janë:*

- Të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t’iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues.
- Të sigurojë dhe të mbrojë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA-së dhe të NATO-s në drejtimet e kërcënuara.
- Monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.
- Organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA-së.
- Të ruajë dhe të mbrojë mjedisin

detar për zbatimin e ligjshmërisë në det.

- Sigurimi i kushteve hidro-lundimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH-së.

- Të ruajë dhe mbrojë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve.

- Të marrë pjesë në përbashkimin e rreziqeve asimetricke të terrorizmit, krimin të organizuar në bashkëpunim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.

Forca Detare (FD) përbëhet nga Komanda dhe Shtabi i FD-së, Kompania e Mbështetjes së Shtabit, Flotilja Detare e cila është reparti kryesor, Qendra e Vëzhgimit Detar, Shërbimi Hidrografik, Qendra e Zhytjes dhe Qendra Stërvitore Bazë Detare.

## Çfarë ofron arsimimi dhe stërvitja në Forcën Detare?

Arsimimi ushtarak për detarët është pjesë integrale e arsimimit të

*“Kur të shkruhet historia e lundrimit botëror, ujërat e brendshme të Shqipërisë do të japin material shumë interesant, që u përket kohërave më të lashta të historisë së lundrimit...”*

lartë të ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Rritja e profesionalizmit, ndërveprimi dhe operacionalitetit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), vijimi i transformimit, modernizimit, përmbushja e angazhimeve në kuadër të Aleancës, rritja e gatishmërisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për garantimin e sigurisë dhe përbashkimin e të gjithë skenarëve të kërcënimeve kërkon një qasje të re në zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor dhe një trajnim individual të personelit për ta bërë atë sa më cilësor dhe fleksibël. Aktualisht nuk ka një Akademi Detarie, e cila për shkak të nevojave të reduktuara për personel nuk ishte e nevojshme për të mbajtur një Akademi Ushtarake Detare.

Përveç rekrutimit të oficerëve nga akademitë detare të vendeve të tjera, rekrutohen edhe oficerë nga Akademia e Forcave të Armatosura dhe degët e navigacionit të universiteteve tona.

Qendra Stërvitore Bazë e Forcës Detare merret me trajnimin në specialitetet përkatëse të personelit nga detar, nënoficerë dhe oficerë sipas kriterëve funksionale. Gjithashtu Qendra Stërvitore Bazë kryen dhe trajnime për institucione të tjera të RSH-së si Policia Kufitare.

Procesi i arsimimit të personelit të FD-së është një sistem i konsoliduar në përputhje me standardet e NATO-s, ku ka si objekt kryesor përmbushjen e të gjithë spektrit të detyrave operacionale si dhe një sistem i unifikuar dhe standardizuar, në përputhje me nevojat dhe detyrimet që shtrohen përpara një force anëtare të NATO-s.

## Cilat janë programet arsimore dhe stërvitore?

Forca Detare si strukturë përgjegjëse për përgatitjen në specialitetet detare të personelit të saj ka Qendrën Stërvitore, në të cilën zhvillohen programet arsimore të specialiteteve detari, të cilat janë pjesë e vijimësisë së

kurrikulave të Akademisë së FA-së të akredituara nga Ministria e Arsimit. Disa prej kurseve funksionale që ofrohen nga kjo strukturë janë:

Kursi Bazë i Oficerit të Marinës, Kursi në specialitetin “Bocman-Sinjalist”, Kursi në specialitetin “Motorist-Elektricitist dhe jetëgjatësia në anije”, Kursi “SAR & Bording”, Kursi në specialitetin “Sistemet e armatimit në anije”, Kursi në specialitetin e ligjshmërisë detare, etj.

Në bashkëpunim me Qendrën e Zhytjeve, Qendra Stërvitore Bazë organizon edhe Kursin Bazë të Zhytjes, i cili është një kurs në nivel kombëtar, ku përgatiten dhe forcat Speciale të FARSH-së dhe ato RENEA të Policisë së Shtetit.

## Çfarë synohet të arrihet mes tyre?

Me zhvillimin e këtyre kurseve, trajnimeve dhe stërvitjeve mundësohet përgatitja e personelit të FD-së në aftësimin profesional dhe fizik në interes të realizimit të misionit dhe detyrave.

## A është në standardin e duhur arsimimi ushtarak profesional i Forcës Detare, për t’i shërbyer realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë?

## Po me atë të shkollave të vendeve të NATO-s?

Ashtu siç përmenda edhe më lart, arsimimi ushtarak për detarët është pjesë integrale e arsimimit të lartë të ushtarakëve të Republikës së Shqipërisë në Akademinë e Forcave të Armatosura të akredituara nga Ministria e Arsimit. Kurset dhe trajnimet e ofruara nga Institucionet përkatëse të FA-së dhe të FD-së që janë në përputhje me kërkesat e kohës dhe të realiteteve të mjedisit të ri të sigurisë ku personeli zhvillohet dhe trajnohet sipas standardeve të NATO-s.

Duke qenë se jemi vend anëtar i



NATO-s, arsimimi ushtarak ka njehsim me dokumentacionin dhe librat e stërvitjes që operohet nga të gjithë vendet e Aleancës, në këtë mënyrë mund të themi se, po, kemi arsimimin e duhur megjithëse duhet punë, pasi arsimimi është një fushë që e ndjek ushtarakun gjatë gjithë karrierës së tij. Pavarësisht trajnimeve që kryejmë në FARSH shumë nga trajnimet dhe kurset, efektivat tanë kanë mundësi t'i kryejnë edhe në vende partnere të NATO-s.

#### **Cilat janë disa prej stërvitjeve më të rëndësishme të FD-së?**

A disponojmë ne burime njerëzore dhe logjistike si ato të 'simotrave' tona të aleancës së NATO-s, pjesë e së cilës jemi dhe ne?

Në aktivitetin e saj, kryesisht pas viteve '90, FD ka zhvilluar si dhe ka marrë pjesë në shumë stërvitje bilaterale si dhe multilaterale, në kuadër të Aleancës si dhe në atë rajonal. Një stërvitje me pjesëmarrjen e disa shteteve anëtare të NATO-s ishte ajo e vitit 2005 COOPERATIVE ENGAGEMENT, ku FD kishte rolin bashkëdrejtues si dhe stërvitja u zhvillua në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë. FD është aktive në iniciativën ADRION, e cila që prej vitit 2006 vazhdon stërvitjet praktike LIVEX, stërvitje që zhvillohet me rotacion, ku çdo vit vendi organizator është njëri nga shtetet anëtare të Iniciativës. Që nga viti i anëtarësimit në Iniciativën ADRION, vendi ynë ka qenë 3 herë vendi organizator i kësaj stërvitjeje. Përtej tyre në mënyrë të vazhdueshme FD ka zhvilluar stërvitje si në ujërat tona territoriale por dhe në ujëra ndërkombëtare, stërvitje me vende si SHBA-të, Angli, Francë, Itali etj. Këto stërvitje kanë bërë të mundur që efektivat jo vetëm të aftësohen dhe të ngrihen profesionalisht por dhe të ndërveprojnë me anijet e NATO-s me detyrat dhe nevojat qofshin ato kombëtare apo nevoja rajonale si dhe të NATO-s. Është e njohur nga të gjithë stërvitja e NATO-s "DEFENDER EUROPE 2022", e cila pat një përf-

shirje nga të gjithë FARSH-të, ku FD kishte rolin kryesor në sigurimin dhe mbështetjen në stërvitjen. Një stërvitje shumë e veçantë është stërvitja bilaterale, e cila u zhvillua me SHBA-të me anijet e Flotës së 6-të të Paqësorit, ku për herë të parë FD zhvilloi qitje me anijet amerikane GUNEX. Të gjitha këto stërvitje bëjnë të mundur aftësimin e efektivave si dhe mundësinë e tyre që të ndërveprojnë me vendet e Aleancës, pasi stërvitjet zhvillohet sipas procedurave standarde të standardizuara nga vendet aleate të NATO-s. Gjithashtu Forca Detare periodikisht merr pjesë me personel ose dhe me anije në stërvitjet ndërkombëtare që zhvillohen nga NATO në vende të ndryshme të rajonit. Si të tilla mund të përmenden pjesëmarrja në stërvitjet "Mare Aperto" në Itali, "NIIRIS" në Greqi, "BREEZE" në Bullgari dhe "SEA SHIELD" në Rumani, etj.

#### **Cilat janë disa prej arritjeve të 10-vjeçarit të fundit të Forcave Detare?**

FD/Roja Bregdetare është një kapacitet aktiv i FARSH-së me angazhimin e saj 24/7. Për shkak të kësaj domosdoshmërie FD stërvitet, trajnohet, por dhe modernizohet, si rezultat i së cilës është edhe pajisja me 4 anije të reja të Klasit ILIRIA, një prej të cilave u ndërtua nga Kompania "DAMEN Shipyards" në Holandë, ndërsa 3 të tjerat u ndërtuan në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në Pashaliman, Vlorë. Gjithashtu ngritja e Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) të RSH-së, me kompaninë amerikane "Lockhead Martin" siguron kapacitete vëzhguese dhe monitoruese të hapësirës detare, duke u ofruar këtë shërbim edhe institucioneve të tjera me interesa në det.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera ligj zbatuese ka sjellë uljen e aktivitetit të jashtëligjshme si dhe garantimin e ujërave tona për një lundrim të sigurt. Si një nga arritjet e Forcës Detare në këtë 10-vjeçar mund të përmendim

pjesëmarrjen për tre vjet rresht me anije dhe personel në Aktivitetin e NATO-s në Detin Egje, pjesë e operacionit të NATO-s "Sea Guardian", ku detyra kryesore ishte kontrolli dhe ndalimi emigracionit të paligjshëm që vinte si rezultat i luftës në Siri si dhe shpëtimi i emigrantëve që u rrezikoheshin jeta në det. Gjatë pjesëmarrjes në këtë operacion anijet e Forcës Detare asistuan dhe morën pjesë në shpëtimin e rreth 3 000 emigrantëve të paligjshëm që u rrezikoheshin jeta në det. Forca Detare mori pjesë për herë të parë në një operacion të drejtuar nga NATO, i cili për herë të parë në FA u mbështet plotësisht nga Forca Detare. Pjesëmarrja në këtë operacion të Forcës Detare u vlerësua maksimalisht nga NATO dhe pavarësisht faktit të sasisë së limituar të kapaciteteve të vendit tonë, përsëri u arrit angazhimi me efikasitet në përballimin e kësaj detyre. Ky lloj angazhimi kërkonte jo vetëm pajisje dhe teknikë por edhe një trajnim dhe stërvitje të mirë të personelit për të përballuar vështirësitë që sjellin kushtet atmosferike dhe deti. Ky angazhim u arrit edhe në sajë të besimit që kishte Ministria e Mbrojtjes, SHPFA dhe vetë Forca Detare në personelin e saj, se ky angazhim do të përmbushej me sukses.

Ambicia e Forcës Detare vijon të rritet mbi bazën e vlerësimit të mundësive tekniko-financiare, por dhe mbi besueshmërinë që kemi në përgatitjen e efektivave. Këtë vit, Forca Detare ka deklaruar pjesëmarrjen në dy operacione të NATO-s për vitin 2023: Rikthehemi në Aktivitetin e NATO-s në Detin Egje si dhe për herë të parë do të marrim pjesë në operacionin e NATO-s, FOCOPS, që ka të bëjë me grumbullimin, analizimin dhe shkëmbimin e informacionit gjatë patrullimit në hapësirën e caktuar detare për sigurinë detare të Aleancës.

Duhet theksuar se viti 2022 ka qenë një sukses jo vetëm për Forcën Detare por edhe për shtetin Shqiptar, pasi gjatë këtij viti u anëtarësuan në dy organizata ndërkombëtare IHO (Organizata

ndërkombëtare e Hidrografisë) dhe IALA (Shoqata Ndërkombëtare e Sigurisë së Lundrimit Detar dhe Fenerëve). Kjo arritje do të përmirësojë sigurinë hidro-lundrimore si dhe mundëson krijimin e standardeve ndërkombëtare në hapësirën tonë detare me qëllim lundrimin sa më të sigurt në këtë hapësirë.

#### **A kanë të rinjtë shqiptarë dëshirë të bëhen pjesë e Forcave Detare?**

#### **Çfarë benefitesh ofron kjo forcë?**

Forca Detare përballlet me të njëjtat sfida si ato të të gjithë Forcave të Armatosura. Rekrutimi i personelit të kualifikuar teknik është një problem edhe në vendet e tjera të NATO-s. Ka një rritje të të rinjve që dëshirojnë për të qenë pjesë e Forcave Detare por që nuk është e mjaftueshme. Duhet theksuar që ndryshe nga pjesa tjetër e Forcave të Armatosura, personeli i Forcës Detare ka specifika të veçanta, pasi puna në anije kërkon specialitete të tilla si navigacion, mekanikë, elektronikë dhe komunikim të cilat përveç se kërkojnë arsimimin e duhur profesional janë profesione edhe shumë të kërkuara në treg.

#### **Cilat janë projektet më të rëndësishme në drejtim të modernizimit të sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës detare, dhe infrastrukturës së reparteve të FD-së?**

Nga pikëpamja e ambicies që Forca Detare ka në vijim për rritjen e kapaciteteve, duke filluar nga viti 2023, projektet më të rëndësishme do të jenë: Kompletimi me një anije patrulluese me kapacitete të mirëfillta luftarake për luftën detare dhe kundërajrore. Për këtë projekt madhor ka filluar puna për hartimin e kërkesave operacionale dhe planifikimin e fondeve të nevojshme për zhvillimin me sukses të këtij projekti. Një projekt tjetër i rëndësishëm është modernizimi i Qendrës së Zhytjes me kapacitete dhe pajisje të afta për skanimin e tabanit të detit me qëllim zbulimin dhe identifikimin e minave detare apo municioneve të mbetura. Gjithashtu projekt i rëndësishëm është

edhe modernizimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD), ku Forca Detare dhe NATO kanë koordinuar për specifikimet teknike të kërkesës operacionale për këtë sistem. Përveç këtyre projekteve madhore të cilat priten të përfundojnë në një periudhë afatshkurtër, në vëmendje janë edhe disa projekte të tjera të cilat përmirësojnë dhe rrisin kapacitetet e Forcës Detare. Si të tilla mund të përmendim kompletimin me 6 anije të reja patrulluese të mesme, të cilat do të zëvendësojnë disa nga anijet e vjetra që kanë përbushur kohën e përdorimit. Në planin afatgjatë një projekt tjetër është edhe kompletimi me një anije shumë-funksionale për Qendrën e Zhytjes dhe Shërbimin Hidrografik.

#### **Cila është sfida më e madhe e afërt e Forcës Detare?**

Forca Detare jeton çdo ditë me sfida operacionale, teknike, të kompletimit me personel, të cilat deri tani i ka përballuar me sukses. Por ajo për të cilën Forca Detare po përgatitet është realizimi i Objektivave të Kapaciteteve nëpërmjet përbushjes me sukses të planeve të modernizimit. Anija me kapacitete të mirëfillta luftarake është objektivi madhor për të ardhmen e afërt por gjithashtu është një objektivi i domosdoshëm, jo vetëm për Forcën Detare por edhe për të gjithë kuadrin e Forcave të Armatosura. Kjo është një sfidë jo vetëm në aspektin financiar por njëkohësisht edhe një sfidë për kompletimin dhe trajnimin me personel, jo vetëm për shfrytëzimin teknik por edhe për përdorimin operacional të teknikës dhe sistemeve të armatimit të saj. Sigurisht duhet theksuar se në këtë rrugëtim të Forcës Detare kemi pasur mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe shpresojmë se ky proces i sapo filluar do të realizohet në bashkëpunim me të gjitha strukturat që kanë lidhje me finalizimin e këtij projekti.





# NATO, forcë dhe unitet

## Mesazhi i Sekretarit të Përgjithshëm për trupat dhe veteranët e NATO-s për fund vitin 2022

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nëpërmjet një mesazhi urimi feste për trupat dhe veteranët e NATO-s, në 20 dhjetor 2022, i falënderoi ata për shërbimin dhe angazhimin e tyre në fund të "një viti si asnjë tjetër".

Ai tha se "Përballë krizës më të madhe të sigurisë në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore, NATO është përgjigjur me forcë dhe unitet, duke vlerësuar forcat aleate për rolin e tyre thelbësor".



### "DRITAT PËR UKRAINËN"

## Selia e NATO-s errësohet në shenjë solidariteti me Ukrainën

Më 21 dhjetor, selia e NATO-s në Bruksel, Belgjikë, iu bashkua monumenteve të tjera ndërkombëtare dhe fiku dritat në orën 20.00 me orën lokale në solidaritet me Ukrainën.

Nisma është pjesë e fushatës 'Dritat për Ukrainën' e nisur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Ukrainës, së bashku me platformën "United 24". Ajo do të zgjasë deri më 31 dhjetor 2022. Qëllimi është të mbledhen fonde për gjeneratorët për spitalet ukrainase dhe të tërhiqet vëmendja e botës për situatën në Ukrainë, në veçanti ndërprerjet në shkallë të gjerë të shkaktuar nga goditjet masive të Rusisë në infrastrukturën kritike, duke lënë popullsinë në kushte të rënda, pa rrymë apo ujë të rrjedhshëm, me kalimin e dimrit.

Aleatët e NATO-s po ndihmojnë Ukrainën të ruajë të drejtat e saj për vetëmbrojtje, të sanksionuara në Kartën e OKB-së. Mbështetje e paprecedentë i është dorëzuar tashmë Ukrainës, duke përfshirë pajisje për riparimin e rrjeteve të energjisë, veshjet dimërore, karburantin dhe gjeneratorët. Në takimin e ministrave të Jashtëm të NATO-s në Bukuresht në nëntor, aleatët riafirmuan mbështetjen e tyre të vazhdueshme për Ukrainën dhe bënë premtime shtesë si pjesë e Paketës Gjithëpërfshirëse të Ndihmës së NATO-s për Ukrainën.



## NATO miraton Drejtimin Strategjik 2023 për Përsheptuesin e Ri të Inovacionit

Bordi i Drejtorëve të Përsheptuesit të Inovacionit të Mbrojtjes të NATO-s për Atlantikun e Veriut (DIANA) ra dakord që elasticiteti i energjisë, shkëmbimi i sigurt i informacionit, ndjeshmëria dhe mbikëqyrja do të jenë fushat prioritare të fokusit për punën e DIANA-s mbi Teknologjitë në zhvillim dhe ndërprerje (EDTs) në vitin 2023. Të tre fushat përbëjnë shtyllën kurriore të Drejtimin Strategjik të DIANA-s për vitin 2023. Drejtimi Strategjik do të nxisë identifikimin e sfidave të para të mbrojtjes dhe sigurisë të DIANA-s, për të cilat duhen gjetur zgjidhje teknologjike me përdorim të dyfishtë. "Ky drejtim strategjik i jep ekzekutivit DIANA udhëzime të qarta për zhvillimin e programeve pilot që do të nisim në pranverën e vitit 2023. Nga këto programe do të përfitojnë komunitetet civile dhe ushtarake", komentoi David Van Weel, drejtori i përkohshëm menaxhues i DIANA.

'Energy Resilience' do të përpriqet të sigurojë që energjia të jetë në çdo kohë e disponueshme dhe e mjaftueshme për të mbështetur misionet dhe operacionet e NATO-s. Zgjidhjet teknologjike në këtë fushë duhet t'i ndihmojnë aleatët të përgatiten më mirë, të minimizojnë, të përshatën dhe të rimëkëmben nga ndërprerjet e parashikuara dhe të paparashikuara të energjisë. Ndarja e Sigurt e Informacionit trajton nevojën për mbledhjen e mbrojtur dhe të besueshme përmes shpërndarjes së të dhënave përkatëse dhe siguron që informacioni i marrë nga të dhënat

rezultante të mund të besohet. Sensimi dhe mbikëqyrja zbatohet gjerësisht për zbulimin dhe vëzhgimin sistematik të fushave fizike dhe dixhitale, në mënyrë që të mundësojë, për shembull, ndërgjegjësimin dhe parashikimin e situatës.

Në të njëjtin takim, Bordi i Drejtorëve zgjodhi Kryetaren e tij të parë, Barbara K. McQuiston, zëvendës shefe e Teknologjisë për Shkencën dhe Teknologjinë, në Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-së, si dhe Zëvendëskryetarin, Imre Porkoláb, Komisioner ministror për Inovacionin e Mbrojtjes, hungarez nga Ministria e Mbrojtjes.

Aleatët e NATO-s ranë dakord të themelojnë DIANA në Samitin e 2021 në Bruksel. DIANA do t'u sigurojë novatorëve të teknologjisë së thellë, me përdorim të dyfishtë në vendet e NATO-s financim dhe një rrugë të shpejtë për të përshatur zgjidhjet e tyre teknologjike me nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë. Kjo do të ndihmojë gjithashtu të sigurojë që Aleanca të ruajë avantazhin e saj teknologjik në fushat prioritare, duke përfshirë përpunimin e të dhënave të mëdha, inteligjencën artificiale (AI), autonominë, kuantin, bioteknologjitë dhe përmirësimin e standardeve të njeriut, energjinë dhe shtytjen, materialet e reja dhe prodhimin e avancuar, hipersonikën dhe hapësirën. Karta e DIANA-s u miratua në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid. Bordi i Drejtorëve, i cili mbajti mbledhjen e tij të parë në tetor 2022, është përgjegjës për qeverisjen organizative të DIANA dhe përbëhet nga një anëtar nga çdo vend i NATO-s.

### PËRGJIGJA NDAJ KORONAVIRUSIT:

## NATO vazhdon të mbështesë Bosnjën dhe Hercegovinën përmes shpërndarjes së pajisjeve mbrojtëse

Ministrja e Çështjeve Civile të Bosnjës dhe Hercegovinës Ankica Gudeljevic dhe komandanti i NATO-s në Sarajevë, gjeneral brigade Pamela McGaha, kryesuan një ceremoni për dorëzimin e pajisjeve mbrojtëse personale autoriteteve të Bosnjë-Hercegovinës, përmes Përgjigjes Pandemike të NATO-s, nga Fondi i Mirëbesimit.

Dhurimi përfshinte 110 000 maska kirurgjikale, 10 000 maska FFP2 dhe FFP3, 20 160 syze sigurie, 20 000 teste antigjenit COVID-19 dhe 210 kuti peceta të lagura. Ai u koordinua nga Qendra Euro-Atlantike e Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive të NATO-s (EADRCC), mekanizmi kryesor i reagimit ndaj emergjencave civile të NATO-s, në përgjigje të kërkesës së Bosnjës dhe Hercegovinës për ndihmë ndërkombëtare.

"Dua së pari të njoh dhe të falënderoj të gjithë heronjtë e kujdesit shëndetësor të Bosnjë-Hercegovinës për dhembshurinë, aftësinë dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm", - tha gjeneral brigade McGaha. "Ky është donacioni më i fundit nga NATO dhe aleatët e saj, që përfshin tre vitet që nga dokumentimi i rastit të parë të COVID; donacionet tona kanë përfshirë maska dhe dezinfektues duarsh, dhe ventilatorë shumë të nevojshëm dhe aparate me rreze X; kjo pajisje do të ndihmojë në riplotësimin e furnizimeve jetike

dhe do të ndihmojë që profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe pacientët të mbrohen", - shtoi ajo. "Ky donacion i fundit shërben gjithashtu për të theksuar përkushtimin e qëndrueshëm të NATO-s ndaj Bosnje dhe Hercegovinës; ne vazhdojmë t'u përgjigjemi kërkesave për mbështetje dhe të ndihmojmë institucionet e Bosnjë-Hercegovinës që t'i mbajnë qytetarët të sigurt", - theksoi gjeneral brigade McGaha.

Ministria e Çështjeve Civile të Bosnjë-Hercegovinës do të shpërndajë pajisjet në objektet mjekësore në të gjithë vendin. Ky donacion plotëson mbështetjen e NATO-s EADRCC të dorëzuar në Bosnje dhe Hercegovinë në 2021 dhe 2022, duke përfshirë 30 ventilatorë, 500 termometra, dhoma me presion negativ IsoArk N36-2, makineri portative me rreze x, teste të antigjenit COVID-19 dhe pajisje mbrojtëse personale.

Kjo mbështetje është pjesë e paketës së përgjithshme të ndihmës së NATO-s për COVID-19. Aleatët kanë rënë dakord t'i ofrojnë Bosnjë-Hercegovinës për të trajtuar efektet e rënda të pandemisë COVID-19. Në javët e ardhshme, Bosnje-Hercegovina do të marrë gjithashtu kominoshe me kapuç të ofruara përmes Fondit të Mirëbesimit të NATO-s për Reagimin ndaj Pandemisë.

## Pema e Krishtlindjeve dhe nisma bamirëse shënojnë fundin e vitit në selinë e NATO-s

Dekorimet festive janë shtuar në selinë e NATO-s, teksa një vit i rëndësishëm për Aleancën po i afrohet fundit.

Tashmë, pema e Krishtlindjeve, 12 metra e lartë, u vendos jashtë Shtabit, në oborr, pranë busullës së NATO-s dhe rrethit të flamurëve të aleatëve. Pema belge vjen nga zona Stavelot e Wallonisë dhe është siguruar nga 'La ferme nos pilifs', një projekt social që promovon bujqësi të qëndrueshme dhe punëson njerëz me aftësi të kufizuara. Pas pushimeve, pema do të bëhet copëza druri dhe mbetjet do të përdoren për shtretërit e bimëve rreth kampusit të NATO-s si pjesë e një nisme më të gjerë gjelbërimit. Një tjetër pemë 4.5 metra është ngritur në Qendrën e Konferencave, ku mbledhet Këshilli i Atlantikut të Veriut. Ndërsa ngjyrat e dekorimit të këtij viti janë bluja dhe argjendi, çdo vit në këtë pemë shfaqet në mënyrë misterioze një tufë e kuqe.

Më 20 nëntor, selia e NATO-s priti aktivitetin e saj vjetor të Bamirësisë, duke mbledhur para për një numër bamirësish belge dhe ndërkombëtare. Këtu përfshihej projekti "Pema e dëshirave", i cili filloi në vitin 2021 për të mbështetur një shkollë në Wallonia që u prek nga përmbytjet dhe këtë vit u fokusua në dhënie dhe dhuratave për fëmijët ukrainas që mbërrinin në Belgjikë. Për të ofruar dhuratat, NATO bashkëpunoi me organizatën belge jofitimprurëse 'Bibliothèques sans Frontières', e cila ndihmon për të lehtësuar aksesin në arsim, kulturë dhe informacion për grupet vulnerabël. Organizata "Aksioni për Ukrainën" operon tre biblioteka në Belgjikë të cilat ofrojnë aktivitete për fëmijë, si dhe kurse gjuhe.





ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gratë nuk e kanë pasur kurrë luksin e të pasurit mjaftueshëm kohë për veten. Nëse i hedh një sy rutinës ditore të disa prej artistëve më të mëdhenj të kohërave (shumica meshkuj) do të vësh shumë aspekte interesante. Gratë u jepnin kohën e nevojshme për të krijuar, shërbëtoret u sillnin rregullisht për të ngrënë e për të pirë ndërsa edukatoret i mbanin fëmijët sa më larg. Le të marrim rastin e Zigmund Frojdit. Gruaja e tij Marta, jo vetëm që i bënte gati ndërresat çdo mëngjes por edhe hidhte pastën në furçën e dhembëve. Kujdestarja e Prustit, Celeste, jo vetëm që e ushqente çdo ditë me brioshë dhe kafe, por ishte aty për të, sa herë kishte ai nevojë për të folur, disa herë kjo ndodhte për orë të tëra.

Bashkëshortja e Karl Marksit jetonte në mjerim bashkë me tre nga gjashtë fëmijët e mbetur ndërkohë që vetë ai kalonte ditët mbi libra në Muzeun Britanik. Kompozitori Gustav Mahler u martua me Almën, një kompozitore e re të cilën e urdhëroi të mos merrej më me art me argumentin se në familje kishte vend vetëm për një artist. Alma kishte një detyrë: të kujdesej që askush të mos bënte zhurmë në shtëpi. Me të mbaruar notin e mesditës, Gustavi i fishkëllente Almës duke e ftuar për një shëtitje, ndonëse këto të fundit bëheshin gjithmonë në heshtje sepse kompozitori ishte shumë i zënë në mendjen e tij. Alma ulej në lëndinë dhe priste deri sa Gustavi të mbaronte së kompozuarit, gjithmonë në heshtje. Në ditarin e saj Alma shprehte dëshpërimin dhe nevojën e madhe që dikush të mendonte për të e ta ndihmonte të gjente vetveten. “Më duket se jam kthyer në një shërbëtoreshë”, - rrëfente ajo.

Ndryshe nga artistët e lartpërmendur, gratë që merreshin me krijimtari e kishin atë të kufizuar nga pritshmëritë dhe detyrat e shtëpisë. Shkrimet e Fransinë Prose ishin në varësi të momenteve kur fëmijët iknin dhe vinin nga shkolla. Alise Munro-së, fituese e çmimit Nobel për letërsinë në vitin 2013, i duhej të numëronte minutat përpara se të shkruante, të pastronte shtëpinë e të kujdesej për fëmijët. Maja Angelou-t i erdhi në majë të hundës dhe u largua nga shtëpia duke u strehuar në një dhomë modeste hoteli, ku arriti të dëgjonte mendimet e saj, të lexonte dhe të shkruante.

Me një sy të lirë dhe vesh të hapur mund të kuptosh që pjesa dërrmuese e librave, pikturave, muzikës, zbulimeve shkencore dhe filozofisë që kemi mësuar në shkolla, kanë si autorë meshkujt.

Me këto shembuj, nuk ka se si të mos arrish në konkluzionin se grave nuk u ka munguar kurrë talenti për të lënë gjurmë në botë me idetë dhe artin

# “Nëse Shekspiri do të ishte grua, nuk do të kish patur kurrë kohë për t’u bërë një gjeni”



e tyre. Thjesht nuk kanë patur kohë!

Gjatë gjithë historisë së njerëzimit, koha e një gruaje është ndërprerë dhe fragmentizuar nga punët e shtëpisë dhe përkujdesja për fëmijët por edhe detyrat tjera me qëllimin e mbajtjes së lidhjeve të forta shoqërore dhe familjare.

Nëse krijimtaria kërkon kohë pa ndërprerje, kohë të cilën mund ta mbash nën kontroll apo gjatë të cilës mund të përqendrohesh pa e vrarë mendjen, atëherë kjo për gratë është një luks i mirëfilltë. Edhe nëse nuk do të ishte luks, një grua do të përshkruhej si egoiste në rast se do të kërkonte kaq shumë kohë për të krijuar sa një burrë.

Në kohët moderne, në krahasim me burrat, gratë shpenzojnë dyfishin e kohës duke bërë punë shtëpie e duke u kujdesur për fëmijët. Po të llogarisim këtu edhe kohën që gratë shpenzojnë në punë dhe karrierë, koha që ato kanë në dispozicion për veten është thajse inekzistente. Burrat në punët e tyre kanë të gjithë kohën që u nevojitet për të krijuar, kërkuar, shkruar dhe publikuar, këtë kohë e marrin pa ndërprerje, sepse u duhet të bëjnë emër, të ecin përpara e të lënë gjurmë.

Studiues të ndryshëm kanë zbuluar se shumë gra dhe vajza ndihen se nuk i meritojnë sa meshkujt ato orët e pushimit gjatë të cilave mund t’i përkushtohen vetes.

Shumë syresh ndihet sikur u duhet të punojnë fort për pak kohë për veten. Por për fat të keq, lista e punëve është gjithnjë e më e gjatë dhe arrin të vrasë ëndrrat e një jete të tërë.

Të mendosh sa poezi, sa nota muzikore e sa vepra arti janë fshehur, zhdukur e fshirë nga faqja e dheut vetëm sepse një grua ishte më e zënë me punët

e shtëpisë. Shkrimtarja Virxhinia Ulf gjithmonë ka shtruar pyetjen se çfarë do të ndodhte me Shekspirin nëse do të kish qenë një grua. “Nëse Shekspiri do të ishte grua, nuk do të kish patur kurrë kohë për t’u bërë një gjeni. Nuk do lejohej të shkonte në shkollë, do urdhërohej të qëndronte në kuzhinë, do martohej shumë i ri dhe do dhunohej”, - shkruante Ulf.

Sipas saj, motra e shkrimtarit ishte shumë e talentuar por u çmend dhe u dëbua në një kasolle në pyll, ku u cilësua si shtrigë dhe më pas u vra. Kompozitori i famshëm Moxart i adhuronte veprat e motrës së tij Nanerl dhe u thurte lavde pa fund. Krijimtaritë e saj u zhdukën sapo Nanerl u martua me një burrë të cilin nuk e dashuronte aspak.

Sa mirë do të ishte nëse ne do të krijonim një botë ku motrat e Shekspirin, Moxartit ose çdo grua tjetër të arrijnë të lulëzojnë pa thundrën e një mashkulli. Çfarë do të ndodhte nëse gratë vendosin se nuk duan të kalojnë ditët duke marrë pluhurat e shtruar tavolinën?

Çfarë do të ndodhte nëse një grua vendos të marrë më shumë kohë për veten, të shpalojë të vërtetat e saj të pathëna e të ushqente veten që në qelizë?

**Përpiquni ta imagjeroni!**

**Historisë kulturore shqiptare thellësisht të dominuar nga burrat i mungon një gjysmë.**

Historia e femrës shqiptare nuk u shkrua, ajo gati nuk ekzistonte si subjekt, historitë e saj mbetën të parrëfyera, vuajtja e saj e pashlyer. Sigurisht gjen aty episode të romantizuara apo heroina novelash e romanësh, të formësuar sipas midesë së krijuesit, njolla e bardhë në histori mbetet, humbja nuk

rikuperohet më.

Kur ecni nëpër qytete e shikoni emrat e rrugëve... sa rrugë mbajnë emra femrash të nderuara?

**Padrejtësi, mëkat historik**

Zëri i saj nuk u mbeti në kujtesën e historisë, u injorua, thjesht se nuk ishte zë burri. Ajo ishte më e mira, vetëm kur sakrifikohej e heshtur. Gruas i shkon buzëqeshja e butë, jo ngritja e zërit dhe revolta. Më saktë ky është krimi më i madh që kreu patriarkalizmi shqiptar në shekuj. Femra është viktima e tij e gdhendur në kujtesën e prapambetjes. Ai ia mbylli gojën, i vuri brezin e virgjinitetit, ia hoqi të drejtën e vetëvendosjes, ia preu rrugët e zhvillimit, duke e privuar me shekuj nga arsimimi e dija, duke e kthyer në makinë lindjeje.

Në kujtesën historike ka hyrë edhe një Teutë, por ajo është alibi. Sado të thuren lavde e të përmendet plot krenari mbretëresha ilire, e cila, sipas disa burimeve, diti të organizojë me gjasë një shtet me të drejta edhe për gratë.

Ajo mbetet vetëm një Teutë.

Ngrihet lart Rozafa e legjendës së murimit, po Rozafa nderohet për vetëmohimin!

Bukuria rrëqethëse e kësaj legjende nuk duhet të na bëjë të harrojmë, Rozafa u vra. Ajo nuk e kundërshtoi fatin e saj që ia përcaktuan burrat.

Po të kishte kundërshtuar Rozafa, të vendoste vetë për fatin e saj, do ekzistonte legjenda?

Edhe një Donikë, që i qëndroi në krah Gjergj Kastriotit e gjen, por edhe roli i saj ishte ai i gruas besnike, ajo ishte aty për të nxjerrë në pah forcën e mençurinë e luftëtarit legjendar.

Jo pak burra, në rast të kërcënimit të nderit e “burrërisë” (së keqkuptuar)

e rivendosnin dhe e rivendosin atë duke përdorur dhunën fizike.

“Askush nuk është ndaj grave më agresiv dhe poshtëruar, se një burrë që nuk është i sigurt në burrërinë e tij”. Tradita, që burrërinë e vërtetë e shikon tek nderi arkaik e jo tek partneriteti, e ka bërë edhe burrin viktimë, pre të modeleve patriarkale të edukuara që në fëmijëri. Jo se ai e urren femrën, ai ka thjesht frikë nga prishja e ekuilibrit që i ka dhënë pushtetin prej shekujsh.

**Një burrë gjen qëllimin e duhur në jetë dhe një grua gjen një burrë me qëllimin e duhur.**

Shëmbëlltyrë për gruan dhe burrin ideal. Ishte një burrë që i shmangu lidhjet e martesës gjatë gjithë jetës së tij dhe kur po vdiste në moshën nëntëdhjetë vjeç, dikush e pyeti: Nuk jeni martuar kurrë, por kurrë nuk keni thënë pse?!

Nëse ka ndonjë sekret, zbulojeni edhe tani, në fund të fundit, ju jeni duke vdekur, duke e lënë këtë botë. Edhe nëse sekretit juaj dihet, nuk do t’ju dëmtojë. Plaku iu përgjigj: - Po, e mbaj një sekret. Nuk është se jam kundër martesës, por gjithmonë kam kërkuar gruan perfekte. E kalova gjithë kohën duke kërkuar dhe kështu jeta ime fluturoi. - Por me të vërtetë në të gjithë planetin e madh të banuar nga miliona njerëz, gjysma e të cilëve janë gra, nuk mund ta gjenit një dhe të vetmen grua ideale? Një lot i rrokullisi faqes së plakut që po vdiste. Ai u përgjigj: - Jo, gjeta një. - Atëherë çfarë ndodhi, pse nuk u martuat? Dhe plaku iu përgjigj: - Ajo grua po kërkonte mashkullin perfekt...

# "O E BUKURA MORE", drithërimat e këngës 600-vjeçare

## Historia e një kënge 600-vjeçare

Kjo këngë mërgimi, kaq e njohur dhe e dashur, jo vetëm për arbëreshët, por edhe për arvanitasit e Greqisë dhe shqiptarët e të gjitha trevave, përmban në vetvete pothuajse gjithë sekretin historik të krijimit të fshatrave të arbëreshëve të Italisë.

*Por shumë pak e dinë kujt  
i kushtohet...!*

*MORE - është një pasthirrmë...?  
Është një vajzë e bukur...? JO!  
MORE, është Peloponezi  
i sotëm i Greqisë!*

Një trevë e madhe, të cilës grekët i kanë ndryshuar emrin nga MORE, në PELOPONEZ, dhe kënga "O E BUKURA MORE", memorizon kujtesën dhe mallin e një atdheu të humbur, është një toponim i këtij vendi nga ku u larguan shumica e arbëreshëve të sotëm të Italisë.

Kjo është ndoshta kënga më e vjetër shqiptare, që mbetet e gjallë akoma edhe në ditët tona e që vjen të na rrëfejë nostalgjinë e madhe, por edhe sekretin historik të krijimit të komunitetit arbëresh të Italisë. I vetmi dokument i kësaj kënge për herë të parë është materiali që gjendet në librin e shkruar nga filologu arbëresh Dhimitër Kamarda në vitin 1866.

Në këtë libër është publikuar për herë të parë teksti i kësaj kënge i shkruar në shqip, por me alfabet grek. Teksti burimor - popullor me ritëm tresh i vetmi version dhe tekst origjinal i këngës "O E BUKURA MORE", por nuk dihet se kush arbëresh i këndoi për herë të parë këto vargje kaq të thjeshta por që mbetën gjallë dhe këndohen po me të njëjtin dhimbje edhe sot.

Botimi i këtij libri u realizua në Itali në vitin 1866 nga shtëpia botuese "F. Albergueti E.C".

Ai mban si titull: "Appendice al Saggio di Grammatologia Comparata



Sulla Lingua Albanese" (Shtojcë e esesë së gramatologjisë krahasuese për gjuhën shqipe), përgatitur me shumë kujdes nga filologu arbëresh Dhimitër Kamarda (1821-1882).

## LARGIMI

Por si dhe pse u larguan arbëreshët e sotëm nga trojet e tyre, nga Moreja (Peloponezi sot), dhe nga Arbëria (Shqipëria sot), si u krijuan katundet arbëreshë në Italinë e Jugut?

Me rënien dhe pushtimin e Koronit (1534), kala që ndodhet edhe sot në More (Peloponezi i sotëm në Greqi), perandori Karli i Tretë, i dha urdhër kapitenit Andrea Doria të marrë grekë dhe arvanitas-arbëror

nga Moreja dhe t'i çojë ata në Italinë e Jugut. Kjo përbën në të vërtetë fillimin e krijimit të fshatrave arbëreshë, por edhe greqishtfolës të Italisë së Jugut.

Në këto momente të shpërnguljes së tyre, arbëreshët kënduan ndoshta për herë të parë këngën "O E BUKURA MORE" me mall dhe vajtim. Shqiptarët e parë që vinin nga Arbëria - Shqipëria sot - u vendosën në Kalabri dhe në Sicili, pas ftesës së mbretit Alfonso i Tretë të Aragonës, bëhej fjalë për luftëtarë shqiptarë, të cilët u vendosën përfundimisht dhe me familjet e tyre në Kalabri dhe Sicili për të ndihmuar përfundimisht luftarak të Mbretit Alfonso në përpjekjen e tij

për të shtypur revoltat dhe lëvizjet e Andegavnonit kundra tij. Pra, krijimi i këtyre fshatrave kishte karakter ushtarak.

Në vitin 1461, vetë Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Kryezot dhe i plotfuqishëm i Arbërisë (Shqipëria sot), me një truproje të madhe dhe të fortë luftëtarësh shqiptarë, do të luftonte në përkrahje të Ferdinandit, djalit të mbretit Alfonso kundër Andegavnonit të Italisë së Jugut dhe princit të Tarontos, dhe për këtë ndihmë dhe përkrahje ushtarake si shpërblim atij iu dhuruan dy feude në Puglia të Italisë.

Kjo popullatë e pasuroi dhe populloi pjesën e shkretuar të kësaj zone dhe njëkohësisht e rrethoi ushtarakisht, duke krijuar kështu një pjesë territoriale të mbrojtur.

Pak para vdekjes së Skënderbeut (1467), por kryesisht mbas vdekjes së tij (1468) dhe rënies e pushtimit të Krujës nga Turqit (1478), një numër i madh shqiptarësh dhe në kushte dramatike do të largoheshin për në Itali dhe do të vendoseshin në fshatrat tashmë të ngritur shqiptare, duke krijuar njëkohësisht dhe fshatra të reja.

Të tjerë shqiptarë u vendosën në Italinë e Jugut me urdhrin e Skënderbeut, si dhe djalit të Joanit në dy feudet e Puglia-s, që i pati dhuruar Ferdinando në Galatina (1845). Një pjesë tjetër shqiptarësh ndoqën nga pas Irini Kastriotin, e cila u martua me princin Bisignano në Kalabri.

Numri i kësaj popullate duhet të ketë qenë shumë i madh, pasi krijoi një zonë përfundimtare me një fizionomi të vetën gjuhësore, kulturore dhe tradicionale, duke

krijuar kështu fshatrat e sotëm arbëreshë të Italisë.

Shqiptarët katolikë të ardhur nga Shqipëria e Veriut, që u vendosën në Italinë e Jugut, u përshatën shpejt me gjuhën, kulturën dhe fenë e vendasve italianë, ndërsa shqiptarët që kishin shkuar nga Shqipëria e Jugut dhe arvanitasit-arbërorë të Mores që nuk ishin katolikë, por ortodoksë, pavarësisht nga kundërshtimet dhe imponimet e peshkopëve vendas italianë, ruajtën të veçantat e kulturës dhe të zakoneve të tyre dhe fenë e ritualin ortodoks bizantin, t'i dallojë ata nga vendasit.

## GJUHA

Gjuha e shumicës së arbëreshëve të Italisë ka shumë ngjyime dialektike, por si bazë ka dialektin toskë, që flitet në Shqipërinë e Jugut dhe me të njëjtin ngjashmëri të gjuhës që flasin arvanitasit-arbërorë të Greqisë.

Prezenca e fjalëve greke është e pranishme dhe kjo ndodh për kohën e madhe të bashkëjetesës së tyre me grekët e perandorisë bizantine.

Shumë prej këngëve arbëreshë përputhen me Morenë, dhe shumë toponime të tjera në këto zona sikurse Koroni, Nafpilo, Korintho...etj.

Sot koha dhe ndryshimet kanë bërë të vetat dhe në mënyrë të pashmangshme hapa të mëdhenj, por nuk kanë mundur të zhdukin apo pluhurosën këtë të veçantë që ka ky minoritet shqiptarësh arbëresh, me gjuhën, traditat, kulturën, zakonet, legjendat e tyre, duke përbërë kështu tashmë një pasuri dhe turizëm folklorik për këto zona.



# COP15: Marrëveshje historike globale për natyrën dhe njerëzit

Në konferencën e OKB-së për Biodiversitetin COP15 në Montreal, Kanada, BE-ja iu bashkua 195 vendeve në Kuadrin historik të Biodiversitetit Global Kunming-Montreal. Ky kuadër përmban synime dhe objektiva globale që synojnë të mbrojnë dhe rivendosin natyrën për brezat aktualë dhe të ardhshëm, të sigurojnë përdorimin e qëndrueshëm të saj si dhe të nxisin investimet për një ekonomi globale të gjelbër. Së bashku me Marrëveshjen e Parisit për klimën, ajo hap rrugën drejt një bote klimatike neutrale, pozitive ndaj natyrës dhe elastike deri në vitin 2050.

Marrëveshja është një kornizë solide me qëllime dhe objektiva të qarta, të matshme, me monitorim të plotë, raportim dhe rregullime rishikuese për të gjurmuar progresin e plotësuar nga një paketë e fuqishme mobilizimi burimesh.

Më shumë se gjysma e PBB-së globale varet nga shërbimet e ekosistemit. 70% e njerëzve më të rrezikuar në botë varen drejtpërdrejt nga speciet e egra. Marrëveshja Kunming-Montreal do të përshpejtojë politikën ambicioze në mbarë botën dhe do të mobilizojë financimin për biodiversitetin nga të gjitha burimet – 200 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2030. Ajo angazhon komunitetin global për veprime për të mbrojtur dhe rivendosur natyrën dhe për të hequr ndotjen – si ato që janë pjesë e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Kjo do të sigurojë që natyra të vazhdojë të mbështesë shoqëritë, ekonomitë dhe komunitetet për dekadat në vijim.

## Objektivat për veprim ambicioz deri në vitin 2030 dhe 2050

Marrëveshja e biodiversitetit Kunming-Montreal përfshin objektivat kryesore globale për:

- Rivendosjen e 30% të ekosistemeve të degraduara globalisht (në tokë dhe det) deri në vitin 2030;

- Ruajtja dhe menaxhimi 30% i zonave (tokësore, ujore të brendshme dhe bregdetare dhe detare) deri në vitin 2030;

- Ndalimi i zhdukjes së specieve të njohura dhe deri në vitin 2050, zvogëlim dhjetëfish i rrezikut dhe shkallës së zhdukjes së të gjitha specieve (përfshirë të panjohurat);

- Ulja e rrezikut nga pesticidet me të paktën 50% deri në vitin 2030;

- Ulja e lëndëve ushqyese të humbura për mjedisin me të paktën 50% deri në vitin 2030;

- Ulja e rreziqeve të ndotjes dhe ndikimeve negative të ndotjes nga të gjitha burimet deri në vitin 2030, në nivele që nuk janë të dëmshme për biodiversitetin dhe funksionet e ekosistemit;

- Ulja e gjurmës globale të konsumit deri në vitin 2030, duke përfshirë uljen e ndjeshme të mbi konsumit dhe gjenerimit të mbetjeve dhe përgjysmimit e mbetjeve ushqimore;

- Menaxhimi në mënyrë të qëndrueshme i zonave nën bujqësi, akuakulturë, peshkim dhe pylltari dhe rritja e ndjeshme e agroekologjisë dhe praktikave të tjera miqësore ndaj biodiversitetit;

- Trajtimi i ndryshimit të klimës përmes zgjidhjeve të bazuara në natyrë;

- Ulja e shkallës së futjes dhe krijimit të specieve aliene pushtuese me të paktën 50% deri në vitin 2030;

- Sigurimi i përdorimit dhe tregimit të sigurt, ligjor dhe të qëndrueshëm të specieve të egra deri në vitin 2030;

- Gjelbërimi i hapësirave urbane;
- Mobilizimi i financave dhe lejimi



i biznesit për të marrë përgjegjësinë për biodiversitetin.

Marrëveshja do të rrisë ndjeshëm mobilizimin e financave për biodiversitetin nga të gjitha burimet, vendase, ndërkombëtare – publike dhe private – duke mobilizuar të paktën 200 miliardë dollarë në vit deri në vitin 2030. Ajo do të krijojë stimuj për burimet vendase dhe ndërkombëtare, duke përfshirë edhe investimet e biznesit.

Ajo trajton gjithashtu subvencionet e dëmshme për biodiversitetin, me angazhimin për të identifikuar deri në vitin 2025 dhe për të eliminuar deri në vitin 2030 një total prej të paktën 500 miliardë dollarë në vit.

Si pjesë e marrëveshjes, BE-ja pranoi një paketë solidariteti ndërkombëtar, veçanërisht për vendet më të cenueshme dhe me biodiversitetin. Fondi i ri Kuadër i Biodiversitetit Global i krijuar në kuadër të Fondit Global të Mjedisit do të jetë i hapur për financim nga të gjitha burimet.

Në një hap të madh për të përmirësuar veprimin e biznesit mbi biodiversitetin, kompanive dhe institucioneve financiare të mëdha dhe transnacionale do t'u kërkohet të monitorojnë, vlerësojnë dhe zbulojnë rregullisht rreziqet, varësitë dhe ndikimet në biodiversitet; dhe të sigurojnë informacion për konsumatorët për të promovuar konsum të qëndrueshëm.

## Angazhimi i BE-së krijon hapësirë për marrëveshje

Uniteti dhe udhëheqja evropiane ishin thelbësore gjatë negociatave katërvjeçare. Në Montreal, ekipi negociator i BE-së, i kryesuar nga Komisioneri Sinkevicius, së bashku me Shtetet Anëtare të BE-së, i koordinuar nga

Presidenca çeke e Këshillit, ia doli të krijonte hapësirën dhe nxitjen e ambiciove paralelisht me progresin në financa.

Marrëveshja është një nxitje e rëndësishme për multilateralizmin, në një kohë kur solidariteti dhe bashkëpunimi global janë më të nevojshëm se kurrë.

Me përfundimin e negociatave të marrëveshjes së re, është koha që të gjitha vendet të zbatojnë kornizën përmes veprimeve të brendshme dhe ndërkombëtare. Përpara COP-së tjetër në 2024, të gjitha vendet duhet të përgatisin Strategjitë Kombëtare të Biodiversitetit dhe Planet e Veprimit, si dhe Strategjitë Kombëtare të Financimit të Biodiversitetit. COP-të e ardhshme do të shqyrtojnë nëse ndikimi kumulativ i veprimeve kombëtare është i mjaftueshëm për të arritur qëllimet dhe objektivat globale për 2030 dhe 2050. Paralelisht me veprimin e politikave, vendet dhe institucionet financiare shumëpalëshe tani do të punojnë për një fillim të shpejtë të mobilizimit të financimit.

Marrëveshja e Gjelbër Evropiane e vendos Evropën në ballë të këtij transformimi ekonomik global. Propozimet tona, si ligji i miratuar së fundmi për zinxhirët e furnizimit pa shpyllëzim dhe puna e mëtejshme për eliminimin e ndotjes, do të nxisin ofrimin tonë në marrëveshjen Kunming-Montreal.

Mbajtja e natyrës të shëndetshme, gjelbërimi i qyteteve tona dhe ruajtja e diversitetit të madh të jetës në planetin tonë janë thelbësore për të ardhmen tonë. Natyra pastron ujin tonë, na jep ushqim me vlera ushqyese, na mbron nga përmblytjet dhe ndihmon në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

## Ndryshimet klimatike: Marrëveshje për një sistem më ambicioz të tregtimit të emetimeve

- Emetimet në sektorët ETS duhet të ulen me 62% deri në vitin 2030
- Kompensimet falas për industrinë do të hiqen gradualisht nga viti 2026 dhe do të zhduken deri në vitin 2034
- Një ETS II për emetimet e karburanteve nga sektorët e ndërtimit dhe transportit rrugor që nga viti 2027

Eurodeputetët dhe qeveritë e BE-së ranë dakord të reformojnë Sistemin e Tregtimit të Emetimeve për të reduktuar më tej emetimet industriale dhe për të investuar më shumë në teknologjitë miqësore me klimën.

Sistemi i Tregtisë së Emetimeve të BE-së (ETS), i cili ruan parimin “ndotësi paguan”, është në thelb të politikës evropiane të klimës dhe kyç për arritjen e objektivit të BE-së për neutralitetin e klimës. Duke vendosur një çmim për emetimet e gazit serrë (GHG), ETS ka shkaktuar reduktime të konsiderueshme në emetimet e BE-së, pasi industrinë kanë një nxitje për të reduktuar emetimet e tyre dhe për të investuar në teknologji miqësore me klimën.

### Ambiciet e shtuara për vitin 2030

Emetimet në sektorët ETS duhet të ulen me 62% deri në vitin 2030, krahasuar me vitin 2005, që është një pikë përqindje më shumë se sa propozohet nga Komisioni. Për të arritur këtë reduktim, do të ketë një reduktim të njëhershëm të sasisë së ndihmave në mbarë BE-në prej 90 Mt ekuivalentë të CO<sub>2</sub> në 2024 dhe 27 Mt në 2026 në kombinim me një reduktim vjetor të shtesave me 4.3% nga 2024-2027 dhe 4.4% nga 2028-30.

Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM), mbi të cilin eurodeputetët arritën një marrëveshje me qeveritë e BE-së në fillim të kësaj jave për të parandaluar rrjedhjen e karbonit, do të futet në të njëjtën shpejtësi që do të hiqen gradualisht shtesat falas në ETS. Prandaj, CBAM do të fillojë në vitin 2026 dhe do të futet plotësisht në përdorim deri në vitin 2034.

Deri në vitin 2025, Komisioni do të vlerësojë rrezikun e rrjedhjes së karbonit për mallrat e prodhuara në BE të destinuara për eksport në vendet jo anëtare të BE-së dhe, nëse është e nevojshme, do të paraqesë një propozim legjislativ në përputhje me OBT-në për të adresuar këtë rrezik. Për më tepër, rreth 47.5 milionë lejime do të përdoren për të mbledhur financime të reja dhe shtesë për të trajtuar çdo rrezik të rrjedhjes së karbonit të lidhur me eksportin.

### Financimi i tranzicionit të gjelbër

Më shumë para do të vihen në dispozicion për teknologjitë inovative dhe për modernizimin e sistemit energjetik.

Fondi i Inovacionit do të rritet nga 450 në 575 milionë ndihma aktuale.

Fondi i Modernizimit do të rritet duke nxjerrë në ankand një shtesë prej 2.5% të ndihmave që do të mbështesin vendet e BE-së me PBB për frymë nën 75% të mesatares së BE-së.

Të gjitha të ardhurat kombëtare nga ankandi i shtesave ETS do të shpenzohen për aktivitete të lidhura me klimën.

Eurodeputetët dhe Këshilli ranë dakord gjithashtu për krijimin e një Fondi Social të Klimës për më të cenuarit.

Vendet e BE-së duhet të matin, raportojnë dhe verifikojnë emetimet nga instalimet e djegies së mbetjeve bashkiake nga viti 2024. Deri më 31 janar 2026, Komisioni do të paraqesë një raport me qëllimin e përfshirjes së instalimeve të tilla në EU ETS nga viti 2028 me një përjashtim të mundshëm deri në vitin 2030 më së voni.

Pas marrëveshjes, raportuesi Peter Liese (EPP, DE), tha: “Kjo marrëveshje do të japë një kontribut të madh në luftën kundër ndryshimeve klimatike me kosto të ulët. Do t'u japë hapësirë qytetarëve dhe industrisë në kohë të vështira dhe do t'i japë një sinjal të qartë industrisë evropiane se ajo shpaguhet për të investuar në teknologjitë e gjelbra”.

ETS është pjesë e paketës “Fit for 55 in 2030”, e cila është plani i BE-së për të reduktuar emetimet e gazeve serrë me të paktën 55% deri në vitin 2030 krahasuar me nivelet e vitit 1990 në përputhje me Ligjin Evropian për Klimën.

# Nuk ka më modalitet aeroplani? Do të lejohen thirrjet në fluturime

**P**asagjerët e linjave ajrore në Bashkimin Evropian (BE) së shpejti do të jenë në gjendje të përdorin telefonat e tyre në mënyrë të plotë në qiell, raporton BBC.

Komisioni Evropian vendosi që linjat ajrore mund të ofrojnë teknologji 5G në aeroplanë, krahas "mobile data" më të ngadaltë.

Kjo mund të nënkuptojë se nuk do t'iu kërkohet më të vendosin telefonin e tyre në modalitetin e aeroplanit - megjithëse specifikat se si do të zbatohet janë të paqarta.

Afati i fundit për shtetet anëtare për të vënë në dispozicion brezat e frekuencave 5G për avionët është 30 qershor 2023.

Kjo do të thotë që njerëzit mund të përdorin të gjitha veçoritë e telefonit të tyre në mes të fluturimit - duke mundësuar thirrjet, si dhe aplikacionet me të dhëna të rënda që transmetojnë muzikë dhe video.

Thierry Breton, Komisioneri i BE-së për Tregun e Brendshëm, tha se plani do të "mundësojë shërbime inovative për njerëzit" dhe do të ndihmojë kompanitë evropiane të rriten.

"Qielli nuk është më një kufi kur bëhet fjalë për mundësitë e ofruara nga lidhja super e shpejtë dhe me kapacitet të lartë," tha ai.

## Fundi i modalitetit të aeroplanit?

Komisioni i BE-së ka rezervuar disa breza frekuencash për avionët që nga viti 2008, duke lejuar disa shërbime të ofrojnë qasje në internet në ajër.

Por ky shërbim ka qenë historikisht i ngadaltë, pasi mbështetej në pajisje për të lidhur njerëzit nëpërmjet një sateliti midis aeroplanit dhe tokës.

Sistemi i ri do të jetë në gjendje të përfitojë nga shpejtësitë shumë më të shpejta të shkarkimit të ofruara nga 5G, e cila sipas rrejtës celulare EE mund të jetë mbi 100 Mbps - duke mundësuar shkarkimin e një filmi në vetëm pak minuta.

Dai Whittingham, shefi ekzekutiv i Komitetit të Sigurisë së Fluturimeve në Mbretërinë e Bashkuar, i tha BBC-së se modaliteti i aeroplanit ishte historikisht i rëndësishëm për shkak të mungesës së njohurive se si pajisjet celulare ndikojnë në avion.

"Kishte një shqetësim se ata mund të ndërhyjnë në sistemet automatike të kontrollit të fluturimit", - tha ai.

"Ajo që është gjetur me përvojë është se rreziku i ndërhyrjes është shumë i vogël. Rekomandimi ka qenë gjithmonë që pasi të jeni në fluturim, pajisjet duhet të jenë në modalitetin e aeroplanit."

Ka pasur një shqetësim në SHBA se frekuencat 5G mund të ndërhyjnë me fluturimet dhe madje mund të çojnë në matje të gabuara të lartësisë.

Por zoti Whittingham tha se kjo nuk është një çështje në Mbretërinë e Bashkuar dhe BE.

"Ka shumë më pak perspektiva për ndërhyrje, - tha ai, - ne kemi një grup



të ndryshëm frekuencash për 5G dhe ka cilësime më të ulëta të energjisë sesa ato që janë lejuar në SHBA".

"Publiku udhëtohet dëshiron 5G. Rregullatorët do ta hapin këtë mundësi, por do të ketë hapa që do të ndërmerren për të siguruar që çdo gjë

që ata bëjnë është e sigurt."

Glenn Bradley, Shefi i Operacioneve të Fluturimit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Mbretërisë së Bashkuar - rregullatori përgjegjës për sigurinë e avionëve brenda MB - tha se përdorimi i telefonave celularë për

të bërë thirrje është i ndaluar në linjat ajrore në Mbretërinë e Bashkuar, përveç nëse avioni është pajisur me një sistem të miratuar të kontrollit të telefonit celular.

"Ne e kuptojmë se planet për të mundësuar fluturimet në bord 5G do

të funksionojnë në brezat e frekuencave më të larta dhe për këtë arsye nuk do të ndërhyjnë në sistemet e avionëve", - tha ai.

"Ne jemi të gatshëm të punojmë me industrinë për të ndihmuar në ofrimin e këtij inovacioni."

## Miliona pasagjerë për 3 dollarë për milje: Vizioni i Wisk për aviacionin autonom

"Avioni "Gen 6" është një taksia ajrore autonome me katër persona. Por Wisk duhet të marrë shumë njerëz në bord për ta bërë këtë punë", - raporton Claire Reilly për CNET.

Nëse Wisk ka rrugën e vet, do të ketë mijëra taksia ajrore që do të fluturojnë nëpër qytetet tona në pak më shumë se një dekadë, duke transportuar deri në 300 milionë pasagjerë në udhëtime të shkurtra për vetëm 3 dollarë për milje pasagjeri, raporton Claire Reilly për CNET.

### Elektronika ushtarake dhe e hapësirës ajrore

"Në vitin 2010, ne vendosëm të gjejmë një mënyrë për të kapërcyer trafikun dhe për të arritur më shpejt në destinacionin tonë", - tha Gary Gysin, CEO i Wisk. "Ai frymëzim evoluoi në një mision për të ofruar fluturim të sigurt dhe të përditshëm për të gjithë. Gjatë 12 viteve të fundit, ne e kemi ndjekur atë mision përmes zhvillimit të pesë gjeneratave të ndryshme të avionëve në shkallë të plotë. Avioni ynë i Gjeneratës së 6-të është kulmi i viteve të punës së palodhur nga ekipi ynë lider në industri, mësimet nga gjeneratat tona të mëparshme të avionëve, përkushtimi nga investitorët tanë dhe evolucioni e avancimi i teknologjisë.

Wisk mbështetet nga dy drejtues të aviacionit, kompania "Boeing" dhe "Kitty Hawk Corporation". Për më tepër, nëpërmjet partneritetit strategjik me Boeing, "Wisk" ka një avantazh konkurrues duke shfrytëzuar 100+ vjet ekspertizë të "Boeing" në zhvillimin e avionëve, prodhimin në shkallë dhe certifikimin. Përveç kësaj, eVTOL dhe burimet inxhinierike të autonomisë së Boeing ndihmojnë në avancimin e mëtejshëm të zhvillimit të Wisk.

### Si taksitë elektrike ajrore mund të tronditin industrinë e linjave ajrore në dekadën e ardhshme

Linjat ajrore komerciale po investojnë në këtë lloj teknologjie për t'i bërë udhëtimet drejt dhe nga aeroporti më të shkurtra dhe më të shpejta për konsumatorët, raporton Mikaela Cohen për CNBC.



Një botë me automjete fluturuese, si sitcom i viteve 1960 "The Jetsons", mund të jetë më afër se sa mendoni. Kompanitë në të gjithë SHBA-në, duke përfshirë disa startup-e, po zhvillojnë taksia ajrore elektrike që synojnë të heqin makinat nga rruga dhe të vendosin njerëzit në qiell. Linjat ajrore komerciale, veçanërisht, po investojnë në këtë lloj teknologjie për t'i bërë udhëtimet drejt dhe nga aeroporti më të shkurtra dhe më të shpejta për konsumatorët, raporton Mikaela Cohen për CNBC.

"Fillimisht, eVTOL-të supozohet të zëvendësojnë makinën tuaj personale", -thotë për CNBC Savanthi Syth, drejtor menaxhues i kërkimit të kapitalit, që mbulon linjat ajrore globale dhe lëvizshmërinë në Raymond James. "Por do të jetë ndryshe për njerëzit, bazuar në vendin ku do të jenë eVTOL."

"Ne mendojmë se do të shihni sasi të vogla të operacioneve [eVTOL] duke filluar në kornizën kohore 2025, me certifikimet që shpresojmë të ndodhin në 2024", - tha Syth. "Por, që ju të shihni shumë avionë që fluturojnë lart, ndoshta do të ketë më shumë gjasa në vitet 2030."



# Moisi Elezi, mbështetësi dhe mbrojtësi i ushtarakut



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

## Shegerti që doli partizan

Moisi Elezi lindi më 15 maj 1926 në Ramicë të Vlorës. Babai, Hamzo Nurçe, ka qenë pjesëmarrës në Luftën e Vlorës, më 1920 dhe në Revolucionin e Qershorit në vitin 1924. Shkollën fillore e kreu në Matogji në vitin 1934, ku mësues i klasës së parë ishte Xhemil Veli Duka, ndërsa në klasë të dytë Ramiz Treni nga Kosova. Në vitin 1936 shkon në Vlorë për të vazhduar shkollën, duke filluar klasën e tretë në shkollën nr. 2, me mësues Musa Muhon nga Tërbaçi, deri në ditët e para të prillit 1939. Në verën e vitit 1940 mbaroi shkollën fillore dhe mori dëftesën e lirim.


Ismail Nurçe nga Vloja që punonte në Tiranë e mori dhe e punësoi në dyqan si shegert, në pazarin e vjetër. Në dyqan shkonin smokthinjtët, që ishin në Tiranë si Shefqet Musaraj, Veiz Pipa, Pajo Islami, Shahin Ruka dhe të krahinës së Mesaplikut si Mumin Selami, Kadri Brahim i etj. Mori pjesë në Luftën e Gjormit në dhjetor 1942. Në verën e vitit 1942 nëpërmjet Pajo Islamit u lidh me grupin edukativ. Këtu u njoh me Manush Alimanin, Ramiz Alinë, Myslim Ketën dhe Adnad Qatipin dhe më pas me Vehbi Hoxhën. U largua nga Tirana në dhjetor 1942 se kishte rënë në sy dhe shkon në Vlorë e më tej në Ramicë. Takon Mevlan Dervishajn, komandant i vendit, dhe i dha disa materiale që kishte prurë. Kërkon të shkojë partizan, por nuk u pranua se ishte tepër i ri. Janar-prill 1943 qëndroi në Ramicë dhe punoi me rininë. Në muajin prill 1943 rreshtohet partizan në çetën "Halim Xhelo", ku komandant ishte Rifat Bajrami dhe komisar Delo Balili.

U bë anëtar i çetës partizane "Zigur Lelo" dhe mori pjesë në të gjitha luftimet e saj. Më tej çeta "Zigur Lelo" u inkuadrua në batalionin "Halim Xhelo" dhe më pas u bë korrier i Komandës së Qarkut Vlorë. Në dhjetor 1943 ishte korrier pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe në mars 1944 qëndron korrier pranë Enver Hoxhës në Panarit.

## Në rrugën e sigurt të ushtrisë

Pas çlirimit të vendit mori arsimin e duhur ushtarak jashtë shtetit, në fillim në Odesë e pastaj në Moskë në Akademinë "Frunze". Ai i ngjiti i sigurt punët e ushtrisë, duke kryer detyrat e larta si kuadër ushtarak. Moisiu e gjen komandant reparti dhe brigade, në organizimin e Ushtrisë, e gjen komandant korpusi, një nga më të lartat të madhësisë operative në ushtri, e gjen pedagog dhe shef Katedre në Akademinë Ushtarake. Të gjitha këto detyra së bashku flasin për kapacitet ushtarak të nivelit të lartë, nivel që lakmohej nga çdo oficer i cili kërkonte të shërbente në fushën ushtarake.

Moisi Elezi kishte diçka të veçantë. Ai eci në jetë dhe i ngjiti shkallët e punëve në ushtri sepse kishte ngjitur më parë



shkallët e ditorisë. Bëri karrierë, por pa bujë, pa zhumë, pa pretendim, të veshura me sjellje shembullore dhe kërkesë po aq shembullore. Fliste avash, po dëgjohej fortë, fliste pak, por dëgjohej shumë. Fliste qartë dhe kurrë me nënkuptime dhe asnjëherë me keqdashje. I përjashtuar nga çdo paragjykim, çdo takim dhe bisedë me të merrte gjithnjë karakterin e këshillës që miqtë dhe kolegët e tij të shumtë e përmendnin dhe sot. Moisiu ishte mbështetës dhe mbrojtësi i ushtarakut.

Pas studimeve në BS kreu në Divizionin I Këmbësor në Tiranë detyrën e agjitpropit dhe të komisarit në Regjimentin 25-të të Këmbësorisë në Kukës. Shërbeu në drejtorinë III të MMP, shef i degës së mobilizimit, zëvendës drejtor, shef i degës së shërbimit të reparteve dhe në Drejtorinë e Përgatitjes Luftarake në MMP, shef i degës së planifikimit. Më tej pas kthimit nga BS për studime të thelluara, kreu detyrën e shefit të Shtabit dhe të komandantit në Brigadën e 5-të të Këmbësorisë në Gjirokastrë. Kreu detyrën e komisarit në Brigadën e 6-të të Këmbësorisë në Përmet dhe të komandantit të Brigadës së 14-të Këmbësore në Leskovik. Në Akademinë Ushtarake kreu kursin e lartë dhe emërohet në drejtorinë e Përgatitjes Ushtarake të shkollave në MMP, ishte zëvendës drejtor, më tej komandant në Korpusin e 4-të të MBD në Tiranë dhe në Akademinë Ushtarake në Tiranë, në detyrën e shefit të Katedrës së Përgatitjes taktiko-operative dhe shef (dekan) i Fakultetit gjitharmësh.

## Në detyrën e shefit të katedrës

Shef i katedrës së PTO-së (përgatitjes taktiko-operative) në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu". Katedra e PTO-së ishte katedra kryesore e Akademisë Ushtarake. Ajo ishte katedra që zhvillonte leksione për luftën në tërësi si fenomen shoqëror, si politikë me mjete të forcës dhe si veprim ushtarak. Jepte njohuri për karakterin e luftës, për ligjet objektive të saj, për elementët e luftës (njeriu, teknika dhe terreni) dhe faktorët politikë, ekonomikë, ushtarakë e gjeopolitikë që e kushtëzonin atë. Përgatiste e zhvillonte leksione për njohjen e Artit Ushtarak të Ushtrisë. Udhëhiqte punën akademike për organizimin dhe realizimin e Luftimit apo të Operacionit të njëjësive të ushtrisë (BrK dhe KK). Pra, ishte katedra ku planet ushtarake lindnin dhe merrnin rrugë dhe planet e armëve e shërbimeve që do merrnin pjesë në veprime ushtarake. Duke qenë në krye të kësaj katedre Moisi Elezi ishte në kreun e trupës mësimdhënëse të Akademisë.

Në Akademinë Ushtarake të viteve '70 të shek. XX kishte tre personalitete ushtarake, të cilët, në bazë të funksionit dhe të aftësive të tyre ushtarake e bënë mundur realizimin e programit akademik. Ata ishin komandant Vehbi Hoxha, zëvendëskomandanti Thoma Xhixho dhe shefi i katedrës së PTO-së Moisi Elezi. Veç punës që kishte në përditshmëri, Moisiu zhvillonte dhe tema të rëndësishme, sidomos kur akademistët studionin e planëzonin veprime ushtarake

të mëdha, në Mbrojtje, në Kundërgoditje dhe në Kundërmësymje të Korpusit, duke drejtuar personalisht, seminare dhe zgjidhje detyrash luftarake.

## Personalitet i mendimit ushtarak

Moisi Elezi ishte personalitet i mendimit ushtarak, personalitet që mbarnte përvoja e karrierë të shkëlqyer ushtarake. Opinioni i tyre kishte shumë peshë në vlerësimin akademik dhe në karrierën ushtarake të akademistëve. Moisi Elezi ishte i veçantë në leksione e në planëzimin luftarak, si dhe në planin profesional e shkencor. Në leksione nuk përsëriste materialin e leksionit, sepse si tekst e lexonin vetë, jua përsëriste vazhdimisht akademistëve. Moisiu shpjegonte, interpretonte parimet, normat, rregullat në të cilat mbështeteshin, por edhe kushtëzoheshin veprimet luftarake, si të forcave tona ashtu edhe të kundërshtarit. Ai qëndronte më shumë në interpretimin e parimeve, të normave e të rregullave që të shpinin në fitore, në luftën e një vendi e të një ushtrie të vogël. Në këto argumente ai qëndronte më shumë.

Moisi Elezi ishte nga ata kuadro madhorë të ushtrisë që i kuptonte, i ndjente vështirësitë që do përballonte vendi dhe ushtria në një përballje ushtarake me fqinjët e aq më shumë në një përballje me blloqet ushtarake, si ne e parashikonim në ato vite. Ai shpjegonte përparësitë e një ushtrie të vogël, por që luftonte për një qëllim të lartë, mbrojtjen e integritetit territorial dhe të lirisë së atdheut, në terrenin e saj

dhe e mbështetur fort nga populli, nga faktorë të tjerë kombëtar e ndërkombehtar, duke prurë shembuj e përvoja fituese të vendeve të vegjël e të ushtrive të tyre. Në kuadër të planifikimit të detyrave luftarake në çdo rast Moisiu i jepte rëndësi sqarimit të detyrave jo vetëm të forcave të këmbësorisë, si ndodhte shpesh, por të të gjithë llojeve të tjera, si AT, AKA, Xhenio, FVVP, FS, shërbimeve si ato të zbulimit, logjistikës, ndërlidhjes, etj. Shumë e rëndësishme ishte që të gjitha forcat pjesëmarrëse në luftim/operacion të funksionin sa më mirë, pasi "edhe një nga elementet më anësor të rreshtimit luftarak të mos vlerësohet, vihet në rrezik suksesi i operacionit", përsëriste shpesh. Duke mbrojtur vendimin luftarak të katedrës së PTO-së, theksonte se edhe ky variant, nuk ishte i përkryer, pasi do të ketë nevojë për ndryshime në bazë të situatave gjatë veprimeve luftarake. Procesi i zgjidhjes së detyrave luftarake me Moisi Elezin ishte një krye leksion. Ai sqaronte shumë paqartësi apo pamundësi për t'i kuptuar më mirë çështjet e luftës së armatosur.

## U shfaq besueshëm në shoqëri

Në marrëdhënie shoqërore Moisi Elezi ishte model, i thjeshtë, i qeshur dhe herë-herë hokatar. Kishte një shtat mesatar, me flokë e vetulla të thinjura, i shkathët në çdo lëvizje që bënte, edhe në ecje, dukej si i ri. Ishte ushtarak profesionist i nivelit të epërm, brilant, njeri, shok, mik e bashkëbisedues i mrekullueshëm. Akademistët takoheshin shpesh me të, kudo, në klasa, në oborr, në shkallë. Në çdo rast e gjente kohën, por kishte edhe mirësinë, sinqeritetin të fliste me akademistët, ai i njihte të gjithë, ishte shok, mik i të gjithëve, kështu, të tillë e kujton Moisi Elezin, ushtaraku madhor Gani Elezi.

Moisiu kishte ngjallur respektin e ushtarakëve. Ai binte në sy mbi të tjerët, sepse ishte me shumë cilësi të lindura. Ai kudo shfaqej me vrull dhe i shoqëruar nga bollëku kulturor, pësia e dendësia e mendimit. Në karrierën e tij ushtarake nga komandantët e tjerë, dinte të mbërrinte deri tek mendimi, qëllimi dhe njëherësh tek zemra e vartësve të shumtë. Në rrugën e tij të dukshme, eci pa bujë. Punët në jetë i bëri bashkë me të tjerët, sepse ai u shfaq besueshëm me thjeshtësi të natyrshme. "Moisi Elezi ka qenë një nga kuadrot më të aftë të ushtrisë. Një nga kuadrot më të zgjuar. Një nga mendjet më të mprehta në fushën e Mendimit dhe të Artit Ushtarak, që unë kam njohur", - është shprehur komandanti i Divizionit të Gjirokastrës dhe Fierit Novruz Dervishaj.

Me daljen në pension u aktivizua me Organizatën e Veteranëve të LANÇ-it dhe me shokët e tij, gjeneralët Vehbi Hoxha dhe Thoma Xhixho.

Moisi Elezi është dekoruar me Medalja e Kujtimit, Medaljen e Trimërisë, Medaljen e Çlirimit, Urdhrin e shërbimit Ushtarak, Urdhrin "Ylli i kuq", Medaljen "10 vjet Ushtri Popullore", Urdhri i Trimërisë, Urdhrin e "Skënderbeut" i Klazit III, Urdhrin e "Skënderbeut" i Klazit II. Për jetën dhe veprimtarinë e tij është botuar libri me kujtime "E dëgjohej se ç' tha Moisiu!?", në vitin 2007.



# Q K M B M M F A

## URON GËZUAR

## KRISHTLINDJET

## & VITIN E RI



JANUARY							FEBRUARY							MARCH							APRIL							MAY							JUNE								
S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S		
1	2	3	4	5	6	7			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	2	3	4	5	6	7	8	7	8	9	10	11	12	13	4	5	6	7	8	9	10			
8	9	10	11	12	13	14	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	9	10	11	12	13	14	15	14	15	16	17	18	19	20	11	12	13	14	15	16	17		
15	16	17	18	19	20	21	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	16	17	18	19	20	21	22	21	22	23	24	25	26	27	18	19	20	21	22	23	24		
22	23	24	25	26	27	28	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	23	24	25	26	27	28	29	28	29	30	31	25	26	27	28	29	30							
29	30	31	26	27	28																																						

JULY							AUGUST							SEPTEMBER							OCTOBER							NOVEMBER							DECEMBER						
S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S	S	M	T	W	T	F	S
						1	6	7	8	9	10	11	12	3	4	5	6	7	8	9	1	2	3	4	5	6	7	5	6	7	8	9	10	11	3	4	5	6	7	8	9
2	3	4	5	6	7	8	13	14	15	16	17	18	19	10	11	12	13	14	15	16	8	9	10	11	12	13	14	12	13	14	15	16	17	18	10	11	12	13	14	15	16
9	10	11	12	13	14	15	20	21	22	23	24	25	26	17	18	19	20	21	22	23	15	16	17	18	19	20	21	19	20	21	22	23	24	25	17	18	19	20	21	22	23
16	17	18	19	20	21	22	27	28	29	30	31	24	25	26	27	28	29	30	22	23	24	25	26	27	28	26	27	28	29	30	24	25	26	27	28	29	30				
23	24	25	26	27	28	29							29	30	31	29	30	31	29	30	31																				
30	31																																								